Shaban Çupi

Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit

Një vështrim i përgjithëm etnografik mbi trevën e Hanit të Elezit
Tradita e shërimit popullor në trevën e Hanit të Elezit
Gjurmëve të vlerave etnomuzikore në trevën e Hanit të Elezit
Mikëpritja në trevën e Hanit të Elezit
Fejesa në trevën e Hanit të Elezit
Dasmat në trevën e Hanit të Elezit
Emërvënia në trevën e Hanit të Elezit
Rituali i vdekjes në trevën e Hanit të Elezit

Hani i Elezit, 2017

Shqiponja e plagosur punim artistik nga Sejdi Dernjani

Fadil Curri

(Recension)

ETNOGRAFIA E RROPOSUR DHE E SHPËRFAQUR E HANIT TË ELEZIT ME RRETHINË

Hani i Elezit me rrethinë është gjeografi e histori e panjohur deri para një decenie kur hulumtimet e publikimet e specifikuara mungonin; së paku ishin si pjesë e dy vendbanimeve historiko-administrative, Skupit si kryeqytet historik nga Dardania ilire e deri në kryeqytetin e vilajetit të Kosovës dhe Kaçanikut me pozitë gjeostrategjike dhe organizative sidomos nën pushtetin e Perandorisë Osmane.

Kohëve të fundit, qoftë në aspektin shkencor ose letrar, pas luftës 1999 sikur u krijua një republikë entuziastësh dokumentues e letrar në Han të Elezit; ata që e kuptonin se të ndihmosh ndriçimin e një pjese të lashtësisë në të vërtetë ndihmon dijen e kulturën etnike si tërësi. Në këtë frymë nuk do mend se njeri emblematik është Shaban Çupi me veprat e tij për historinë e tokës e nëntokës, heroizmat e këtij komuniteti liridashës e bujar. Këtë e dëshmoi edhe me dorëshkrimin që mëton të jetë libër, "Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit.

Kjo vepër e Shaban Çupit ka synim që, jo vetëm banorëve të kësaj ane, por edhe të tjerët të interesuar ta njohin kulturën e trashëgiminë që në ndërkohësi është shndërruar në etnografi, t'ua ofrojë kureshtarëve të kësaj fushe.

Nuk është lehtë të rroposësh tokën e historinë e kësaj ane, edhe më e vështirë është kur nuk posedohet ndonjë traditë hulumtuese dhe që përpjekjet duken si të pakrahë, të izoluara dhe e pashteg. Megjithëkëto përballje, autori nuk tundet para qëllimit të tij dhe është kurajoz kur hulumton mjekësinë poopullore para ndonjë

shekulli deri në ditët e sotme, “mjekët” dhe sëmundjet “lunga”, “fryma”, “lidhja” seksuale e emocionale, sidomos e dhëndurrëve, por edhe shëruesit e sëmundjeve të shumta shpirtërore, siç ishin Halil Rrogaçi e hoxhë Mejdi Dernjani.

Kur jemi te këto dy figura, është interesant shembulli i të parit, i cili mjeshtërinë e shërimit telepatik popullor e mëson nga bashkëvuajtësi i tij në burgun e Mitrovicës së Sremit (Vojvodinë, Serbi), që nënkuptohet se sëmundjet dhe shërimi i tyre nuk janë problem vetëm i kësaj ane, por brengë panshqiptare. Kuptohet, qasja e Shaban Çupit është cytje për zbardhjen e mëtejshme e këtyre figurave dhe veprave të tyre bëmirëse-shëruese.

Pjesë etnografike janë edhe emrat e njerëzve dhe të vendbanimeve, demografia e tyre nëpër faza të ndryshme kohore. Shumë regjistra e statistika janë objekt hulumtimi dhe që kanë të bëjnë me banorët e vendbanimeve të kësaj ane në të dy krahët e lumit Lepenc dhe Grykës së tij. I rreket patronimisë dhe mikrotoponimisë që haset në këto anë dhe në njëfarë mënyre përgënjeshtron dealbanizimin e tyre nga pushtuesit, sidomos të fundit sllavë, por sjell edhe synime për kthimin në shqipësinë e natyrshme. Bie fjala, rrjedha e kulturës fetare nëpër histori që disa studies ta shtrembërojnë shqiptarësinë, në këtë libër rezulton se vazhdimësia shqiptare në këtë anë është edhe nga koha paraislamike, me sjelljen e emrave thjesht shqiptarë, si Gjoni, Stepani, Leka, Pali e tjerë që hasen në toponiminë e patroniminë e kësaj ane.

Në këtë libër shprehen përpjekje për vitalizimin kulturor të jetës së njeriut, qoftë shpirtërore, qoftë materiale. Lindja, fejesa, martesa, pagëzimi i fëmijëve, puna, mulliri, objektet sakrale, toka gratçore, disa njësi folklorike gjatë shënimit të këtyre dukurive, mjetet e ushqimit e të punës, veshmbathjet e deri te ndërtimi i shtëpive, lidhja e jetës me tokën e ambientin jetësor e shumë momente që e ndërtojnë etnografinë, i gjejmë në faqet e këtij libri,

sidomos atë fshatar, qoftë me fjalë shpjeguese, ose me fotografi, apo përmes tabelave të defterëve osmanë ose statistikave të tjera të burimeve të ndryshme arkivore.

Edhe nëntoka e kësaj ane është interesante, falë punës arkeologjike vullnetare të autorit dhe që përmes tyre na del civilizimi i hershëm dhe vazhdimësia shqiptare. Duke dashur që lexuesve t'ua bëjë më të qartë shtjellimet, sjell edhe literaturën e shfrytëzuar me asnjanësi e korrektësi faktizuese.

Marrë në tërësi veprën hulumtuese e ndriçuese të Shaban Çupit për ndriçimin e historisë shpirtërore e materiale, edhe kjo që i qaset etnografisë, mund të themi se atë që bëri Shtjefën Gjeçovi për kulturën, arkeologjinë e etnografinë shqiptare, sinonimi i tij lokal për Hanin e Elezit është Shaban Çupi, autori i librit "Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit".

Fjala e autorit

Treva e Hanit të Elezit, si një vendbanim që shtrihet ndërmjet Kaçanikut dhe qytetit të lashtë dardan të Skupit, natyrisht se paraqet një interes jo të vogël në zbardhjen e jetës, etnografisë dhe historisë së kësaj treve në të gjitha dimensionet e sajë.

Në rrjedhë të kësaj ,,zbardhje'' historike e etnografike, mendojmë se i kemi arritur t`i realizojmë objektivat kryesore të këtij qëllimi, andaj në aspekt të ndriçimit të kësaj treve, konstatojmë se ajo nuk është më si më parë dhe errësira historike që ka dominuar deri më tani, nuk është më.

Ne nuk mundemi që me saktësi të konstatojmë se nga cili vit apo shekull ka frymuar jeta në këtë trevë, por duke u mbështetur në gjetjet arkeologjike (Pllaka-stellë e zbuluar në vitin 1995), mund të themi se jeta në këtë vendbanim daton nga shekulli III i erës sonë.

Në këtë libër, ne u munduam që trevën e Hanit të Elezit ta trajtojmë në aspekt etnografik duke u munduar që të futemi sa më thëllë në gurrën e traditës sonë dhe kemi ngritur mjaftë tema, besojmë me interes për lexuesin dhe meqë këto tema trajtohen për herë të parë, jemi të vetëdijshëm se kanë edhe mangësitë apo të metat e tyre.

Libri ,,Gjurmime etnografike në trevën e Hanit të Elezit '' në tërësinë e tij përmbledh këto njësi studimore:

Një vështrim i përgjithëm etnografik mbi trevën e Hanit të Elezit
Tradita e shërimit popullor në trevën e Hanit të Elezit
Gjurmime etnomuzikore në trevën e Hanit të Elezit
Mikëpritja në trevën e Hanit të Elezit
Fejesa me shkuesi në trevën e Hanit të Elezit
Dasmat në trevën e Hanit të Elezit
Emërvënia në trevën e Hanit të Elezit
Rituali i vdekjes në trevën e Hanit të Elezit.

Të gjitha këto tema apo njësi hulumtuese, janë të ndërlidhura njëra me tjetrën dhe marrë në tërësi e plotësojnë natyrshëm gjurmimin të cilin ne e quajtëm Etnografik.

Që ky libër të vie deri tek lexuesi është dashur që të kalojë nëpër burime të ndryshme shkencore, duke përfshirë edhe defterët osman. Është plotësuar me kujtesën popullore dhe argumentuar me relikte e artefakte të ndryshme arkeologjike e etnografike.

Meqë botimi i parë i këtij libri(në vitin 2016), u mirëprit nga lexuesit dhe interesimi i tyre vazhdon të jetë edhe sot, vendosëm që librin të e botojmë si botim të dytë, me ndryshime, në vitin 2017.

Krejtësisht në fund, për suksesin e këtij libri, falëndërojmë ndihmën e pakursyer të recensentit Fadil Curri dhe lekturuesit Imri Trena, ndërsa për ndihmën materiale për botimin e dytë të këtij libri, falënderojmë Komunën e Hanit të Elezit.

Autori, 2017



Hartë gjeografike e komunës së Hanit të Elezit

Një vështrim i përgjithshëm etnografik mbi trevën e Hanit të Elezit

Treva e Hanit të Elezit është një mjedis etnogjeografik shqiptar dhe në hapësirën e saj territoriale përfshinë këto vendbanime: Fshatin Kryenik, Guranë, Rezhancë, Seçishtë, Puset e Nikës, Dimcë, Dërmjak, Paldenicë, Neçavc, Laç e Vërtomicë si dhe vet qytezën e Hanit të Elezit.

Një pjesë e vendbanimeve të kësaj treve i përkasin Meleve të Sharrit, ndërsa pjesa tjetër Maleve Rodope të Karadakut të Shkupit. Përmes kësaj treve, gjallëron lumi Lypena (Lepenci) i cili nga Sharri, përkatësisht Lypeteni, vie nëpërmjet Grykës epike të Kaçanikut dhe në Bardhanë bashkohet me lumin Vardar ku së bashku vazhdojnë udhëtimin e tyre për në Detin Egje.

Si vendbanime janë evidentuar edhe në Defterët turko-osman e madje me fshatra të konsoliduara me 20 e 30 shtëpi dhe vet numri i tyre tregon se këto vendbanime kanë qenë të „gjalla'' edhe para ardhjes së osmanlinjëve në këto troje.

Mbeturinat e themeleve të vjetra, gjurmët e kalave, reliktet e gjetura arkeologjike, qeramikat, gypat e ujësjellësit, gërmadhat e kishave, toponimet e mikrotoponimet domethënëse si dhe rruga e vjetër Via De Zenta, sikur e dërgojnë këtë trevë në thellësitë e lashtësisë iliro-dardane.

Katundi gurra e ngjarjeve

Jeta e banorëve të kësaj treve, historikisht ka qenë jo e lehtë. Dimrat ishin të rëndë e stina e verës e thatë. Toka ishte jo aq pjellore dhe punohej me parmend e pllug dhe të gjitha këto ndikonin që edhe bereqetet të mos jenë edhe aq të mira.

Katundi si vendbanim, ishte epiqendra dhe gurra e ngjarjeve. Ai si bashkësi ekonomike e shoqërore, determinohej me territorin e përbashkët, përkatësisht me kufinjtë e këtij territori, me detyrimet

materiale ndaj shtetit dhe me rregullin e brendshëm[1] dhe siç thotë etnografi Mark Krasniqi ,, Gurra e traditës sonë është e begatshme, por ajo dita-ditës vjen duke e pakësuar ujët, prandaj duhet nxituar që nga kjo gurrë të mbushim sa më shumë enë''.[2]
Katundin, si gurrë e ngjarjeve, e përbënin familjet e mëhallët që kishin një harmoni mes veti dhe solidaritetin ndaj njëri-tjetrit e shfaqnin në formën e argatisë; qoftë në lëvrimin e arave me kuajë e qe, në prashitjen e arave të misrit, në korrje të drithërave me drapër ose në kositje të livadheve.[3] Brenda tij frymonte jeta, ruheshin adetet, zakonet, lojërat, këngët e vallet. Gëzoheshin kur pas natës së gjatë dilte drita, ndërsa shqetësoheshin kur mbi kulm të shtëpisë këndonte qyqja. Numri i pikave të zeza në Lulemarre ishte masë matëse e turpit në shoqëri dhe shqetësoheshin kur pikat e zeza pakësoheshin. Qitnin pushkë gëzimi kur lindte një fëmijë, ndërsa vajohej e grrithej fytyra kur vdiste ndokush.
Katundi si vendbanim më i hershëm, ruante dhe kultivonte rregullat e jetës. Kishte të parin e tij apo kryeplakun dhe tentohej që jeta të zhvillohej në mënyrën autoktone, kështuqë edhe binin ndesh me ligje e zakone të pushtuesve.
Familjet ishin të mëdha dhe me shumë kurora. Organizimi i mënyrës së jetesës bëhej nga i zoti i shtëpisë dhe pavarësisht se sa e rëndë ishte jeta, familja e madhe si numër, ngërthente në vetvete sigurinë dhe fuqinë. Në rrethana fatkeqësish, fjala e familjeve të mëdha kishte rolin e tyre vendimarrës. Në trevën e Hanit të Elezit, jeta organizohej sipas rregullit të fisit, mëhallës e katundit, por nuk mbahet mend që të jenë organizuar edhe sistemi i bajraqeve. Këtë mënyrë organizimi të jetës, sado patriarkale që ishte, pushtuesit vazhdimisht janë munduar ta zhdukin e bashkë me atë, janë përpjekur të tjetërsojnë edhe zakonet, traditat, këngët, vallet

[1] Mark Krasniqi ,,Lugu i Baranit'' fq.47
[2] Mark Krasniqi ,, Nga gurra e traditës'' Prishtinë 1991
[3] Ndihma në formën e argatisë, në trevën e Hanit të Elezit, është praktikuar deri kah viti 1980

dhe veshjen tonë. Gjithmonë, nën vellon e shkatërrimit të së vjetrës, synohej të zhdukeshin gjurmët iliro-shqiptare.

Shtëpitë

Katundet, zakonisht ngriteshin rreth maleve e në sukore të kodrave, ndërsa shtëpitë ishin kryesisht dykatëshe dhe të ndërtuara me gurë, ndërsa dritaret ishin të vogla dhe me grila. Që të ndërtohej një shtëpi, duhej që me muaj të tërë të barteshin gurët dhe tranat të cilët ishin nga bunga e qarri. Puna ishte aq e rëndë sa që thuhej se: "Kur ndërtohet shtëpia, ose qetë ngordhin ose i zoti i shtëpisë sëmurej''. Pasi në themele prehej një kurban për mbarësi, fillonte ngritja e shtëpisë. Radhiteshin gurët njëri pas tjetrit dhe lidheshin me baltë e cila përzihej me byk. Gushakët e drurit ishin pjesa tjetër lidhëse e murit dhe kur përfundonte kati i parë, vendoseshin trajtë të cilët lidheshin me gozhda e kllëfa hekuri. Pllafoni shtrohej me dërrasa bungu dhe njëkohësisht mbulohej me baltë. Oxhaku i shtëpisë fillonte që nga kati përdhesës dhe vazhdonte ndërtimi i tij edhe në katin e dytë. Në katin përdhesës ishte dhoma e shtëpisë me oxhak, ku qëndronin gratë dhe ndahej përgjysmë me bagëtinë, përkatësisht lopët të cilat ishin pasuria e familjes. Në katin e parë ishte edhe dhoma e çarranikut ku mbaheshin bulmetërat si dhe ,,izba''për mjete pune. Kati i dytë i saj kishte odën e mysafirëve dhe dhomat e tjera përcjellëse të vëllezërve, të gjitha këto të shtruara me jana e çilima, jastëk kashte e dyshek prej leshi, cerga, postaqia e hastra. Kur shtëpisë i ngritej kulmi, familja e farefisi, për mjeshtrit, sjellnin ,,bakshishë'' zakonisht peshqirë, këmisha dhe gjëra tjera. Pas kësaj, kulmi mbulohej me qeremide e kulumarë. Ndarja e dhomave është bërë me gurë e çerpiçë, ndërsa lyheshin me baltë e byk e në fund, fjalën e kishte gëlqerja. Varësisht nga besueshmëria e mjeshtërit që ndërtonte shtëpinë, në kuadër të murit ndërtohej një ,,bunker'' për mbajtjen e armëve dhe në ballë vendosej guri që maskonte atë.

Muri dhe ,,bunkeri'' për mbajtjen e armëve

Oborri rrethohej me avli, murë guri i cili pos derës së madhe në hymje, kishte edhe derën e kapigjikut. Për ato familje që ishin më të varfëra, oborrin e rrethonin me huj e thupra të shkozës. Personi që kishte më shumë bagëti në oborr kishte edhe ahurin e kafshëve, por gjithsesi në oborr të shtëpisë ishte edhe hambari i misrit, i drithit, lugjet e bagëtive dhe koritat për ujë. Në oborr ishte bunari për ujë të pijes i cili murosej me gurë, mbi të cilin ngritej një kulm i vogël për t`u mbrojtur nga shirat, ndërsa në fund të tij vendoseshin dy dërrasa bungu të kryqëzuara.

Shtëpitë që ndërtoheshin në trevën e Hanit të Elezit, ishin nga guri, të tipit kulla të vogla dhe shoqëroheshin edhe me çardak. Në të shumtën e rasteve, nevojtoren dhe hamamgjikun e kishin në kuadër të shtëpisë, në pjesën e jashtme të murit. Dera e shtëpisë natën mbyllej me shul, ndërsa për roje të shtëpisë shërbenin qentë.

Pamje nga ana e pasme e shtëpisë së Nuhi Rexhep Bravës në Puset e Nikëse, pas ndërhyrjes emergjente në vitin 2013

Drithërat

Në trevën e Hanit të Elezit, nga drithërat kultivohej: gruri, elbi, thekra, jarica, meli, tërshëra, misri dhe të gjitha këto bluheshin në mullinjë të cilët në këtë trevë kanë qenë të shumtë. Mbillej edhe orovi për kafshë si dhe pekmezi i cili ndryshe quhej edhe ,,kallamoq pekmezi'' sepse rritej i gjatë rreth tre metra, por jo më i trashë se gishti i dorës. Pasi nxirrej lëngu i tij dhe zihej, pastaj lyhej buka. Në fshatin Seçishtë është mbjellë edhe orizi.

Drithërat korreshin me drapërinjë dhe ara mbushej dorëza-dorëza që në trevën e Hanit të Elezit quheshin ,,pollogja''. nga të cilat me lektira lidhej duaji. Lektira prodhohej nga kashta e thekrës, pasiqë thekra rritej e gjatë. Shirja e drithërave bëhej në lamë e cila para se të shtroheshin duajt, lyhej me bajga të kafshëve. Pasi lyhej lama me bajga, në atë mënyrë qëndronte disa ditë që të terej. Pas kësaj, rreth murrallit vendoseshin duajtë dhe më pas fillonte fshirja e lamës. Ajo zakonisht bëhej me kuaj të cilët silleshin e rrotulloheshin në lamë pothuajse gjatë tërë ditës, derisa kokrra e grurit ndahen nga kalliri. Kur kokrra e grurit ndahej nga kashta, kashta futej në mashën për ushqim bagëtishë, ndërsa gruri grumbullohej në lamë dhe hidhej me tërplotë duke e ndarë kokrrrën e grurit nga byku dhe pas këtij procesi ndarës, gruri i

ngarkuar në thasë të dhijtë dërgohej në mulli dhe bëhej miell. Shirja e grurit në lamë, në trevën e Hanit të Elezit është bërë deri në vitin 1982.
Lufta për kokrrën e grurit ishte luftë për jetën. Shumë familje nuk mundnin ta siguronin atë. Edhe më e rëndë bëhej kur tokat i mbulonte thatësira. Rendimentet bienin, kështuqë krijohej kriza e bukës. Në trevën tonë njihej kriza e bukës për dy vite me radhë në kohën e Bugarit të Dytë, gjatë Luftës së Dytë Botërore Kishte raste kur gruri fshihej në dhoma se ta merrnin. Kjo ka ndodhur edhe pas përfundimit të luftës sidomos në kohën e „otkupit'' jugosllav, kurë nga shqiptarët kërkohej që të dorëzonin tepricën, ndërsa në fakt ata nuk e siguronin as të domosdoshmen.
Nga fauna, në trevën e Hanit të Elezit jetojnë: lepuri, ujku, ariu, shqarthi, derri i egër, dhelpëra e shumë rrallë kaprrojtë. Kultivoheshin edhe pemët e perimet, por në të kaluarën ka qenë e zhvilluar edhe vreshtaria.
Drunjët që rriteshin ishin; bungu, qarri, ahu, krekëza, lajthia e kryesisht shkoza e ndër ato rritej edhe druri i frashnës me lëvozhgat e të cilit pasi ziheshin, ngjyroseshin tirqit e xhamadanët . Nga druri i frashnës gdhendej edhe një dru i vogël në formë trekëndëshi i cili quhej Japrak[4] dhe vendosej në djepin e fëmisë kundër mësyshit si dhe në kokën e kafshëve.
Si njësi matëse të peshës përdoreshin: kutulla(6 okë), shniku (17-18 kg) dhe oka (130 kg), ndërsa për gjatësi; kuti (64-80 cm) e pashi (rreth 1 metër e 30 cm-1 metër e 50 cm, varësisht prej krahëve të njeriut), ndërsa çetelja ishte copë druri e ndarë në dy pjesë dhe përdorej për të mbajtur llogaritë në mes shitësit e blerësit.
Kur ndonjë mysafir shkelte në konaçet e këtyre vendbanimeve, mblidhej i tërë katundi dhe shkonin te mysafiri i cili nderohej me mikëpritje e muhabet dhe nuk mungonin as kënga e lojërat e ndryshme, sidomos ajo e Filxhanave. Për të nderuar mysafirin,

[4] Informatë nga Elham Kalisi, Hani i Elezit

cigarja i dhezej me eshkë[5], gur stralli e unur e cila kur dhezej, lironte një aromë tepër të mirë.

Shkallët për në katin e dytë të shtëpisë, Puset e Nikës

Hixhiena

Higjiena trupore, mbahej në kushte të rënda. Në mungesë të mjeteve higjenike siç i kemi sot, përdorej sapuni dhe Humëza. Humëza është dhe, përkatësisht lloj dheu, afërsisht i përngjanë kitit dhe pasi nxjerrej nga toka, formonin toptha të vegjël dhe pastaj është përdorur për pastrimin e flokëve, në formë shamponi. Në shumicën e rasteve, Humëza është përzier me një sasi të vogël vajguri dhe kjo përzierje ka ndihmuar në shkrehjen e flokëve të vajzave, të cilat i kanë pasur të gjata deri në bel. Humëzën e

[5] Eshka gjendet në drujë, lisa ahu. Merrej eshka dhe zihej në ujë me fi (hi). Pasi zihej mirë, nxjerrej nga uji dhe thahej shumë. Unuri ndërtohej nga çeliku (lima).Pos eshkës, duhet gjetur edhe gurë stralli(gurgac) dhe pastaj guri ofrohej afër eshkës dhe me unur i bie gurit i cili me xixat e tij e dhez eshkën dhe eshka krijonte flakën. Eshka duhet mbajtur në vend të terur.

gjenin në vende të ndryshme, por më së shumti, Humëz ka te Dheu i Bardhë në Han të Elezit.
Krahas Humëzës, për pastrimin e rrobeve, është përdorur Fini. Pasi vlonin ujin në kazan, merrnin hirin nga oxhaku dhe e hedhnin në ujin e valë në kazan dhe pas qëndrimit për një kohë të caktuar, ujin e vluar me hi e kanë qitur mbi rrobe, sidomos mbi pëlhura dhe kështu e bënin pastrimin.

Krimbi i mëndafshit

Në mungesë të mjeteve të punës, nënat dhe gjyshet tona, në trevën e Hanit të Elezit prodhonin edhe mëndafshin i cili përdorej në qëndisjen e pëlhurave, marhamave dhe kryesisht pajës së nusërive. Mëndafshin e prodhonin nga krimbi i mëndafshit, duke u mbështetur në dy faktorët kryesor: klimës së vendit dhe drurit të Manit të Bardhë. Pasi merrnin krimbat i mbështjellnin me gjethe të Manit të Bardhë dhe njëkohësisht i ofronin kushte nxehtësie. Brenda këtyre kushteve, krimbat shumoheshin dhe formonin gëzhollen e rreth saj, fijet e mëndafshit.
Se mëndafshi është prodhuar në trevën tone, krahas Xhezide Çupit 1925-2006 e pohon edhe Nezakere Dernjani nga fshati Paldenicë[6] e martuar në Shkup, por edhe drugdhendësi Jakup Kaloshi (1941) nga fshati Guranë[7], i cili dëshmon se kur kam qenë fëmijë rreth 10-12 vjeç kam parë plakat e katundit duke prodhuar mëndafshin nga krimbat. Ai thotë se krimbi ushqehet me gjethet e manit dhe grumbulli i krimbave mbështjellen me gjethe mani të cilët pastaj formojnë gëzhollen e rreth saj fijet e mëndafshit.

Arkeometalurgjia

Në trevën e Hanit të Elezit, ishte e zhvilluar edhe arkeometalurgjia, përkatësisht farkëtaria. Kjo paraqitej si nevojë për prodhimin e mjeteve të punës si: plori, sopata, kazma, kmesa,

[6] Informatë nga Nesim Dernjani dhënë autorit Shaban Çupi më 18.9.2013, Paldenicë
[7] Informatë e Jakup Kaloshit (1941) dhënë autorit Shaban Çupi më 18.9.2013, Hani i Elezit

drapri, turrjela, heksi, çekani, dalta, patkonjët, gozhdat, të gjitha këto produkte të hekurit i cili para se të formësohej, nxehej në furrën e farkëtarit dhe prodhohej mjeti punues. Gjurmët e arkeometalurgjisë i kemi ende të ,,gjalla'' edhe sot. Arkeometalurgët përmenden edhe në kohën e mesjetës në deftërët turk si në Kryenik në formën Nikolla i biri i farkëtarit. Arkeometalurgjia ishte e zhvilluar edhe në fshatin Guranë e më vonë edhe në fshatin Paldenicë dhe në Han të Elezit. Sot, në trevën e Hanit të Elezit, kemi vetëm një farkëtar. Ndërsa vorbëtaria ka qenë e zhvilluar vetëm në fshatin Seçishtë, prej kah edhe sot ruhet mikrotoponimi ,,Vorba''.

Parmenda

Lëvrimi i arave bëhej me parmendë e cila krahas zgjedhës që kishte, përbëhej edhe prej këtyre pjesëve: dorëzës, lloparit dhe umit. Lëvrimi i arës me parmendë në trevën e Hanit të Elezit është bërë deri në vitin 1975. Pas parmendës është përdorur plugu derisa traktori u bë mjeti bashkëkohorë i lëvrimit të arave. Mbjellja e misrit dhe fasules(bathës) bëhej hulli për hulliri, ndërsa e grurit bëhej me shpore dhe para se të hedhej gruri në arë, ai vendosej në duqi (hejbe).

Tip shtëpie ku kanë jetuar familje me shumë kurora

Motiv pune në fshat në të kaluarën

Motiv dasme, para luftës së vitit 1999

Kavallat për muzikë[8] dhe thurje në vek

Shpatë e vjetër

[8] Kavallat i ka ndërtuar mjeshtri i njohur Hamdi Bela (1900-1965) nga fshati Gjergjedell dhe janë të vjetër rreth 60 vjet. Tani janë në pronësi të Mervet Kalisit në fshatin Seçishtë

Shtama mbi hastër

Palareja dhe qerepi për pjekjen e bukës

Tavitja në lamë[9]

Ariu i murrëm në Puset e Nikës, janar 2016

[9] Fotografi marrë nga interneti

Gjuetarët me „trofeun'' e tyre, janar 2016

Trari karakteristikë në një shtëpi dhe gdhendjet ornamentale

Dollapi dhe oxhaku si pjesë të brendëshme të dhomës

Dibeku mbi hastër

Lloj tjetër dibeku dhe kosh blete

Tradita e shërimit popullor në trevën e Hanit të Elezit

Njëra nga lëmenjtë e shkencës së etnologjisë, pa dyshim është edhe etnomedicina (apo mjekësia popullore). Çdo popull ka zakonet e veta shëruese dhe në njëfarë mënyre i pengon dhe i lufton sëmundjet e ndryshme që e godasin njeriun.[10]

Mjekësia popullore zë vend të rëndësishëm në kulturën tradicionale të çdo grupi etnik dhe në çdo mjedis etno-gjeografik. Kjo është një mjeshtri e llojit të vet, e cila bën pjesë në kulturën materiale dhe në kulturën shpirtërore, sepse në shërimin e sëmundjeve të ndryshme ,,mjeku popullor'' përdorë bimë, barëra të ndryshme, ose mënyra tjera materiale.[11] Mjekësia popullore është temë e gjërë dhe me interes të posaçëm për studim nga aspekte të ndryshme shkencore, madje edhe nga aspekti i shkencave aplikative.[12]

Brenda zakoneve të mjekimit popullor ka zakone materiale (lëndore) - shërim me ,,medikamente'' dhe zakone magjike-shërim psikiatrik, por ka edhe zakone të kombinuara[13] dhe siç thotë etnologia e njohur Drita Statovci ,, zakonet e përmendura gjer tani nuk janë të rastit, por janë pasqyrë e përpjekjeve të njeriut të kohërave të caktuara dhe këto kanë një histori pas vete dhe në vete''.Mjekësia popullore ndër ne është mjaft e zhvilluar, sepse deri vonë fshatari ynë nuk ka pasur mundësi të kërkojë ndihmë nga mjekësia bashkëkohore, e cila as në qytet nuk ka qenë e zhvilluar sa duhet e si duhet.[14]

Se sa mjekësia popullore ishte e rëndësishme dhe me vlerë, flet edhe një e dhënë tjetër: Kur në në vitin 1967, në Shqipëri, nisi lufta kundër fesë, nën sloganin "feja opium për popullin" dhe ku regjimi komunist ngriti kazmën ndaj kishave dhe xhamive anembanë vendit, punonjës të Arkivit Qendror të Shtetit, morën

[10] Drita Statovci ,,Disa të dhëna për mjekësinë popullore në trevën e Opojës''
[11] Mark Krasniqi,,Nga gurra e traditës'', Prishtinë 1991, fq.318
[12] Mark Krasniqi ,,Lugu i Baranit'' fq.146
[13] Gjurmime albanologjike-folklor dhe etnologji, nr.21, 1991 fq. 124(shkrim i Drita Statovcit)
[14] Mark Krasniqi ,,Nga gurra e traditës'' Prishtinë 1991, fq 40

nën mbrojtje aq sa mundën, dokumente me vlerë që gjendeshin në bibliotekat e tyre, kryesisht libra e fletore, ku përshkruhen magji dhe mjekësi popullore si pjesë e mjekësisë osmane…dhe dokumente të tilla të shumta ruhen edhe sot në Arkivin Qendror të Shtetit[15].

Me trashëgiminë e shërimit popullor si pjesë e trashëgimisë shpirtërore, ka shumë vite që merrem, madje që nga paralufta e vitit 1999. Gjurmët e para nga mjekësia popullore i kam mësuar nga bisedat me pleq e plaka dhe nuk ishte e lehtë të depërtoje në ,,zanatin'' e tyre, pasiqë këto,,sekrete'' shërimi i mbanin për vete. Kam hasur raste kur pleqtë e plakat ,,zanatin'' e tyre ua kishin lënë si trashëgim pasardhësve të tyre.

Kam synuar që nga terreni ta vjelë këtë trashëgimi shpirtërore e materiale dhe t`ua përcjellë brezave që ta dinë, ta kuptojnë, ta krahasojnë dhe ta vlerësojnë se sa e vështirë ishte jeta e parardhësve të tyre, përkatësisht se çfarë përpjekje bënë ata për të sfiduar sëmundjet që nuk ishin të vogla në mesin e tyre. Edhepse në dukjen e parë, mënyrat e shërimit janë arkaike, madje edhe të habitshme, mjekësia shkencore duhet të ketë në konsideratë këtë trashëgimi mjekësore, pasiqë në detaje fshihen gjëra me vlera të mëdha, e aq më tepër, kur dihet fakti se disa sëmundje, përkundër përparimit të madh shkencor e teknologjik, as sot nuk u gjendet shërimi.

Mjekët tanë popullor, krahas veprimit fizik me pacientin, përdornin edhe veprimin frymor-frymën, të cilat nëse i analizojmë fjalë për fjalë gjejmë mesazhe me interes. Edhepse pacienti nuk e dëgjonte, frymën e mjekut" dhe nuk dinte kuptimin e saj, fjalët e thëna nga mjeku në fshehtësi, krijonin efektin psikologjik mbi pacientin dhe si pasojë ndodhte shërimi, andaj fusha e psikologjisë shkencore, mjekësinë popullore duhet ta ketë si një ,,minierë'' të sajën.

Në trevën e Hanit të Elezit, pothuajse çdo vendbanim kishte mjekët e tyre popullorë. Këta mjek, ,,frymën'' e kishin mësuar

[15] Burimi: interneti,, Mjekësia osmane në Shqipëri''

nga paraardhësit e tyre dhe në momentin e marrjes së saj, fillimisht duhej që t`i „fryenin'' një shelnjeje, por më e preferuar ishte që t`ia vjedhnin „frymën'' shëruesit apo shërueses. Për të trashëguar „frymën'' preferohej edhe një mënyrë tjetër që dhënësi dhe marrësi, ndërmjet të kenë një vijë uji. Më së shumti kjo lloj mjekësie ishte e përhapur te gjinia femërore, ndoshta nga shkaku se ata ballafaqoheshin drejtëpërsëdrejti me sëmundjet e fëmijëve. Mjete materiale nuk merrnin nga pacientët, pasiqë këtë punë e bënin për shpirtin e tyre, por nuk kundërshtonin të merrnin ndoj gjë, siç thonin „sa për të zënë dora''.

Në hulumtim të mjekësisë popullore, kontaktova shumë shërues, por që nuk dëshirojnë t`ua përmendim emrin, pasiqë gjithë këtë punë të tyren e kanë bërë për shpirtin e tyre dhe unë respektova dëshirën e shprehur. Megjithatë, në qendër të studimit, gjithsesi fokusova Fletoren e mjekut popullor Halil Rogaqi nga fshati Rezhancë e cila ka edhe historinë edhe parahistorinë e saj.

Në mesin e mjekëve popullor

Para lufte e pyeta hoxhën e fshatit Paldenicë, Mejdi Dernjanin (1932 - 2004): - Si po i shëron hoxhë njerëzit, që po vijnë tek ju për shërim? Disa, familjet e tyre po i sjellin të lidhur me zingjirë e kur po dalin prej shtëpisë tënde, po shkojnë të shëruar?!

Ai m`u përgjigjë: - Çdo sëmundje që e ka dërguar Zoti ka lënë edhe shërimin; ka lënë edhe „sebepin'' e shërimit, vetëm njerëzit duhet ta kërkojnë atë, ta gjejnë dhe t`i zbatojnë këshillat që u japim dhe në vazhdim më tregoi për një rast të një mjeku maqedonas i cili kishte ardhur te ai për shërim.

Kur hyri në dhomë, nga gjuha e kuptova se është maqedonas dhe natyrisht nga një besim tjetër religjioz, dhe i thash: - A të ka treguar shoqëruesi yt(shqiptar) se unë me profesion jam hoxhë? - Po, tha ai dhe vetëm kjo derë më ka mbetur. Mjekësinë e kam shtjerruar, se mjek jam vet dhe goja që më është shtrembëruar, nuk erdh se nuk erdh në vendin e vet, andaj jam ardhur tek ju që t`më bëni derman. Fillova t`i lexojë pjesë të Kuranit që i përgjigjen natyrës së sëmundjes së tij. Goja dalëngadalë filloi t`i vinte në vendin e vet, por ai nuk e shihte; ishte në procedurë të

shërimit. Unë vazhdoja leximin e Kuranit, por edhe goja po i vinte në vendin e vet. Dhe kur e kreva punën time, e afrova të sëmuarin te pasqyra dhe i thash: - Shikoje tash fytyrën tënde, a është tani në rregull? Ai i kënaqur nga shërimi, më përqafoi me tërë fuqinë e tij. Një rast tjetër që mund ta veçoj, se kam shumë raste për të treguar, e sollën një burrë të lidhur me zingjirë, vërtetë ishte një pamje e rëndë. Nga sytë e hetova se në atë njeri ishte futur xhindi dhe sundohej nga ai. Sapo e futën në dhomën time, iu afrova t`ia zgjidhë duartë, por familja nuk pranonte! - Mos hoxhë, më thanë ata, do t`na mbysë! Që mos t`i frikësoj ata, ashtu të lidhur, fillova ta shëroj me lexim Kurani dhe në vazhdim të shërimit ia zgjidha duartë, ndërsa familja shikonte e druajtur. Tani brenda tij zhvillohej një luftë e tëmerrshme, e mira me të keqen... U shërua, u gëzua familja, u gëzova edhe unë. Në makinë hipi si është më së miri.
E si i din këto - e pyeta unë përplot kurreshtje? Të gjitha këto m`i mësoi Kurani, libri i shenjtë, tha ai. Dhe vërtetë, si shërojnë këta njerzë, pa medikamente e pa operacione?

...dhe vazhdova rrugëtimin tim hulumtues.

Gjatë hulumtimit, gjeta natyra të ndryshme të sëmundjeve, si: magjia¸ lidhja e burrit natën e martesës, çmenduria, zilia, ftohja, era, kolla, veremi, anemia, kafëshimi i gjarpërit, infektimi, përdredhja, shurdhimi, dallaku, majasili, lunga, gunga, mësyshi, memecëria, dregëzat, lythat, fryëmarrja, pikat e zeza në këmbë, shterrpësia e grave të martuara e plotë sëmundje të tjera të cilat kishin ndodhur e ndodhin nëpër kohë, por pyetja kapitale është kjo: **Si shëroheshin njerëzit, kur në trevën e Hanit të Elezit s`kishte as mjek e as Qendër të Mjekësisë Familjare?**

Hoxhë Mejdi Dernjani (1932-2004)

Në hulumtim të mjekësisë popullore në trevën e Hanit të Elezit, vizitova edhe shtëpinë e Shaban Rogaqit, pasiqë e dija se gjyshi i tij Halil Rogaqi ka shëruar sëmundje të ndryshme. - Po, kjo është e vërtetë, u përgjigj Shaban Rogaqi. Gjyshi im Halili ka lindur në vitin 1892 dhe ka vdekur në vitin 1969. Për veprimtari politike është arrestuar nga OZN-a jugosllave në vitin 1948. Ishte strehues, informues dhe bukëdhënës i kaçakëve antijugosllav në krye me Avdyl Durën e Durajve të Kaçanikut. Për këtë vepër, gjyshi im Halili u dënua me 5 vite burg të rëndë. Në hetuesi ia thyen krahun dhe bënë kastrimin e përjetshëm të tij. Pasi u dënua në Gjilan, gjyshin tim e transferuan në burgun e Mitrovicës së Sremit dhe atje e mbajti burgun. Në Mitrovicë të Sremit, Halili ka mbajtur burgun me plotë të dënuar të tjerë dhe kishte shumë shqiptarë të burgosur e në mesin e tyre edhe një hoxhë nga rrethina e Shkupit, emrin e të cilit e kemi harruar. Hoxha i Shkupit, për të cilin Halili kishte thënë se ishte ,,myderris'' në fe, ishte i sëmurë nga tuberkulozi dhe për çdo ditë trupi i tij shterrohej dhe vdekja e tij

ishte e sigurtë dhe e shpejtë. Një ditë, hoxha i kishte thënë: Halil, jeta ime po merr fund, unë dua ta lë një amanet dhe besoj se kam gjetur njeriun e qëlluar. Para se të bie në burg, unë me ,,frymën'' time kam shëruar shumë njerzë, andaj nëse ma jep besën se kur të dalësh nga burgu, me ,,frymën'' time do t`i shërosh edhe ti njerëzit, unë po t`i tregoj mënyrën e shërimit të tyre dhe pasi u pajtova me amanetin e tij, ditë për ditë e natë për natë më tregoi mënyra të ndryshme të shërimit të cilat i dëgjoja për herë të parë dhe dalëngadal fillova t`i shkruaj në një fletore burgu, por meqë nuk dija alfabetin shqip ,, frymën'' e hoxhës e shkrova me fjalët shqip, por me shkronja çirilicë.

Fletorja e Halil Rogaqit

Mjeku popullor, Halil Rogaqi

Nga fletorja e Halil Rogaqit, shënova, analizova e krahasova shumë metoda shërimi prej të cilave përzgjodha këto:

Për shërim nga gjarpëri

Pesë mënyrat e shërimit nga kafshimi i gjarpërit, metodë e Halil Rogaqit

Mënyra e parë :

Pasi e zinte gjarpërin, ia ngulte një gjilpërë në kokë dhe e lëshonte. Gjarpëri nga dhembja e madhe vraponte me shpejtësi nëpër livadhe dhe aty ku u ndalte, bënte rreth, rreth një fije bari dhe kështu zbulohej bari shërues dhe pasi e grimconte atë, e vendoste në plagë.

Mënyra e dytë:E mbyte gjarprin dhe e vendoste në një shishe derisa e kalbte. Pastaj ndante veç eshtrat e veç mishin. Pastaj mishin e pjekte në një enë mbi zjarr, pastaj e shtypte derisa e bënte pluhur e pastaj pluhuri përdorej për të mjekuar varrën ku gjarpëri kishte kafshuar qoftë njeriun, qoftë kafshën.

Mënyra e tretë:

Nga gjarpëri e prente kokën dhe bishtin, trupin e hudhte. Kokën dhe bishtin i pjekte mbi shporet dhe i shtypte derisa bëheshin

pluhur, pas kësaj merrte gur kali dhe e kombinonte me pluhurin. Pastaj pluhurin e vendoste mbi plagë, por paraprakisht plaga duhej të shtrydhej që të nxjerrte gjak.

Mënyrë e katërt: Prente një pulë, e ndante për gjysmë atë, dhe gjysmën e pulës e vendoste në pjesën ku e ka kafshuar gjarpëri.

Mënyra e pestë Merrej nishadra dhe shtypej mirë. Pasi nishadra bëhej pluhur, me pluhurin e saj, lyhej vendi ku kishte sulmuar gjarpëri.

Mënyra të tjera, nga mjek tjerë popullorë për shërim nga kafshimi i gjarpërit

Mënyra të tjera shërimi nga kafshimi i gjarpërit bëhej edhe ,,me frymë''edhe me veprim fizik, sidomos kur gjarpëri kafshonte kafshët.

Ai apo ajo që fryente për kafshim gjarpëri, në momentin që merrte lajmin, pavarësisht në pozitën e punës që ishte, ashtu duhej të qëndronte dhe shqiptonte këto fjalë:

Ore i keq
Ore i gemt
T`shkela në bisht
M`kaqe në gisht.
Ku i ke ilaqet?
N`zgjedhë të kive
N`zallë të rekës
Në kinla.

Fjala ,,gemt''është fjalë e vjetër nga fjalori i gjuhës shqipe, fjalë e cila më nuk përdoret dhe kuptimi i saj është: i shtrembët, zikzak, pra lëvizja e gjarpërit është zikzake dhe fillimisht ai konsiderohet ,, i keq''. Se përse është përdorur si shëruese edhe ,,zgjedha e kive'' nuk dijmë si ta shpjegojmë, ndërsa të tjerat si ,,zalli i rekës'' dhe ,,kinlat'' (kinlat janë bimë që kanë kokërra të zeza) kuptohen nga efekti i veprimit të tyre, pasiqë kur kinlat lagën në ujë dhe marrin rërën e rekës dhe me ato fërkohet plaga, natyrisht se ajo do të shpërthej në gjak dhe shpërthimi i tij e tërheq edhe gjakun e helmuar.

Se sa është e vjetër kjo metodë shërimi, saktësisht nuk mund ta themi, por kur e pyeta mjeken popullore para se të vdiste në moshën 85 vjeçare në vitin 2006, se nga kush e ke mësuar këtë „frymë'' më tha: -Nga gjyshja, nëna e babait të saj.

Pra, kafshimi nga gjarpëri ishte një veprim i shpejtë pasiqë helmi i tij atakonte me shpejtësi gjakun. Veprimi i parë bëhej me lidhjen e vendit me tojë(spagë), në lakun e parë të gjymtyrës ku kishte sulmuar gjarpëri dhe pastaj, krahas këtyre veprimeve „frymore'' dhe fizike, pacienti dërgohej në spital, sidomos në spitalin e Shkupit i cili ishte në afërsi të Hanit të Elezit në largësi prej 22 km. Por, kur as në Shkup nuk kishte spital, atëherë pacienti detyrimisht duhej t`i nënshtrohej mjekësisë popullore.

Një **mënyrë tjetër**, që mjekët popullor e përdorën në trevën e Hanit të Elezit për shërim nga gjarpëri është edhe kjo:

Gjen një akrep me shumë këmbë i cili gjendet në plehëra, ku ka lëgështi dhe e mbytë. Akrepin e fut në një shishe e cila ka zejtin. Pasi trupi i akrepit kalbet, në shishe ai lëshon helmin që ka. Me këtë lëngë lyhet plaga.

Mënyrë tjetër:

Personi që ka mbytur gjarpërin me këmbë, para Shëngjergjit, shëron kafshimet që gjarpri ka bërë ndaj kafshës. Mjafton që me këmbë, mbi plagën e kafshuar të bëj një veprim kryqëzues në formën e shkronjës (X).

Në rrugëtimin e mëtejmë të hulumtimit të mjekësisë popullore gjetëm sëmundjen e quajtur „ Lunga''.

Në kosultim me fjalorin e Gjuhës shqipe, gjetëm se:

Lunga është xhungë e mbushur me qelb, e cila zë shtrat thellë në mish; çoban, i thatë. Lungë e keqe, tumor i keq, fshikëzezë, lungat e qafës.

Nga vet kuptimësia që na e jep Fjalori i gjuhës shqipe, sëmundja e lungës ishte serioze „tumor i keq'' dhe zakonisht lunga dilte nënsqetull, në gilëz të këmbës dhe kudo ku gjymtyrët e trupit lakohen.

Shërimi i saj bëhej edhe me „frymë'' edhe me veprim fizik. Po cilat ishin mjetet e shërimit që përdorte mjeku popullor?

Ishte thika, një krahën, një gri e cila e mprehte sopatën dhe një rrem fshise që fshinim shtëpitë si dhe tre gurë të vegjël.
Pasi tuboheshin mjetet e punës, duhej të përzgjedhej koha, duke u errësuar, pra pas perëndimit të diellit. Pacienti duhej të shkonte në qoshe jashtë shtëpisë ,, nër strehë '' dhe mjekja fillonte shërimin. Sëmundja, krahas dhembjes përshkohej edhe me ethe.
Veprimi; Shprehja me fjalë:
-Hupu se të mpreha, fryente mjekja dhe me grih tri herë e lëvizte ate mbi lungë;
-Hupu se të preva, fryente mjekja dhe me thikë tri herë lëvizte mbi lungë;
-Hupu se të fshina, fryente mjekja dhe me rrem fshise tri herë vepronte mbi lungë
Pastaj nga streha e shtëpisë gjente tre gurë të vegjël dhe me secilin gurë thoshte,, Hupu se të shkula'' duke e lëvizur gurin mbi lungë dhe përsëri gurin e vendoste në vendin e vet dhe i sëmuari shërohej.
Te një shëruese që kishte fry për lungë për 60 vite me radhë, gjetëm me pak dallime të njëjtën mënyrë veprimi, pos asaj që një gur dhe fshesa gjuheshin pas shpine.
Është karakteristike se edhe sëmundja e gungave në qafë dhe ajo e gjirit të grave, janë shëruar afërsisht njëjtë.
Është me interes të theksohet se mjekë popullor kam hasur edhe në vende të tjera, si në Kaçanik dhe e tërë mënyra e shërimit nga lunga është afërsisht e njëjtë, pavarësisht se shëruesit nuk janë takuar kurr mes veti. Me këtë konstatojmë se shërimi nga sëmundja e lungës është e lashtë dhe nuk mund të përcaktojmë kohën e saj.

Kundër hidhërimit

Njerëzit, gjatë jetës së tyre, përballen me probleme, hidhërime, strese, zhgënjime, dilema e dyshime e të gjitha këto populli i quante,, të idhëta''. Këto ,,të idhëta'' që nuk ishin të rralla ndër shqiptarë, kërkonin shërim, andaj mjeku popullor, zbuloi edhe mënyra shërimi kundër ,,vesveseve'' të tyre e siç thonë ata, shërimi ishte i suksesshëm.

Me pacientin veprohej në atë mënyrë që tek ai të krijohej efekti psikologjik i shërimit. Së pari i fryhej me „frymë'' në fytyrë të sëmuarit. Pastaj fryhej uji dhe pacienti e pinte më tepër se gjysmën e tij. Me ujin që mbetej, lagej zverku dhe gropëza e qafës e cila gjendet nën gushë.

Kundër të lehurave të qenëve

Në hulumtimin e mjekësisë popullore gjetëm edhe një rast me interes një „ frymë'' interesante të cilën e përdornin kaçakët e maleve.

Kaçakët, nëpër kohë të ndryshme, kanë qenë prezent edhe në malet tona. Ata kanë jetuar në male në kushte të rënda dhe të fshehur nga „hiqmi'' i cili i kërkonte. Si të tillë, ata kishin nevojë për bukë e gjëra të tjera jetësore, kështuqë duheshin të udhëtonin natën për te „jatakët'' e tyre. Lehja e qenëve, lajmëronin të zotin e shtëpisë për lëvizjet e egërsirave në fshat ose lëvizje të njerzëve të panjohur, kështuqë kaçakët rrezikoheshin, andaj duhej edhe një „frymë'' kundër lehjes së qenëve.

Mënyra e veprimit:

Kaçaku duhej që në orët e natës të shkonte te varret dhe të ulej mbi një varr. Pasi ulej në varr, duhej që me duar mbas shpine të merrte një grusht dhe nga varri dhe me duartë mbrapa e me dheun në grusht, duhej të shkonte në shtëpi, në këtë rast, në strehimoren e tij. Kur shkonte në shtëpi ose në strehimoren e tij, dheun e fuste në një qese dhe e lidhte mirë që të mos derdhej. Pastaj qesen me dheun brenda e lidhte në trup, kështuqë edhepse udhëtonte nëpër fshatra, qenët më nuk lehnin! Këtë mënyrë veprimi e kemi gjetur në Fletoren e Halil Rogaqit, me shërimin numër 35.

Ndër sëmundjet e shpeshta, sidomos te meshkujt, ishte zënia e kanaleve të urinës dhe paraqiste sëmundje serioze, andaj mjekësia popullore kujdesej edhe për këtë lloj shërimi dhe në trevën e Hanit të Elezit, kemi gjetur dy mënyra shërimi.

Mënyra e parë: Kur bllokoheshin kanalet e urinës dhe pacienti s`mund të urinonte, merrnin disa kalaveshë qershie dhe i thanin bishtat e qershisë. Bishtat e pasi të thaheshin, i zienin dhe lëngun e tyre e pinin. Mjeku popullor, kujdesej që në kohën e qershive t`i

mblidhte dhe t`i thante bishtat dhe ato t`i përdorte në çdo kohë me pacientët e tij.

Mënyra e dytë: Mënyrën e dytë të shërimit nga kjo sëmundje e kemi marrë nga Fletorja e Halil Rogaqit e cila mban shënimin, shërimi numër 5

Personin e sëmurë duhet shtypur pas kokës, te zverku, dhe duhet lënë në borë për një kohë të caktuar. Në fletore nuk jepen sqarime të tjera, por nënkuptojmë se shtypja në kokë ka të bëj me enët e gjakut dhe qarkullimin e tyre, ndërsa lënia e personit në borë ka të bëj me të ftohtin, ndoshta nga i ftohti bëhet tkurrja e prostatës dhe në këtë mënyrë bëhet hapja e kanaleve për urinim.

Kundër djegëjes

Mënyra dhe kushtet e jetës në trevën e Hanit të Elezit, ndikonin që edhe djegëjet me valë e me qumësht të jen të shpeshta. Meqenëse mjekut në kohëra të vjetra, nuk i dihej as emri e mos të flasim për shërbime ambulantore, urtakët popullor zbuluan edhe mënyrën e shërimit nga djegëja dhe kjo ende praktikohet. Për shërim nga djegëja, në trevën e Hanit të Elezit gjetëm disa mënyra:

Mënyra e parë

Te mënyra e parë e shërimit gjetëm metodën edhe me ,,frymë'' edhe me veprim fizik dhe jo vetëm që shërohej pacienti, por edhe gjurmët e djegëjes zhdukeshin.

Mjekja popullore merrte një vezë pule dhe nga veza e pulës hiqej të bardhët e vezës dhe ,,fryhej'' të kuqtë e saj. E kuqja e vezës kombinohej edhe me vaj ,,pampuri'' ose me vaj amvisërie(zejtin) dhe pastaj merrej një pendël pule dhe me të kuqin e vezës lyhej plaga. Lëkura fillimisht thahej dhe përsëri lyhej dhe kjo ,,terapi'' bëhej për disa ditë me radhë. Pacienti jo vetëm që shërohej, por as gjurmët e degies nuk mbeteshin.

Mënyra e dytë:

Në Fletoren e Halil Rogaqit për shërimin nga e djegëta gjejmë këtë shënim:

Merret hudhra, zejtini (vaji) dhe pisha dhe ky lloj i shërimit e mban numrin 8

Mënyra e tretë:

Mënyra e tretë përmban dy veprime fizike. Në veprimin e parë përdorët gëlqerja e shuar. Nga gëlqerja merret uji i cili i përngjan cikut dhe me këtë ujë e lyejmë plagën dhe ky veprim hjek temperaturën.
Pas këtij veprimi merr një qepë dhe e grimcon atë mirë e mirë. Pasi ta grimëcosh atë e qet në një tigan i cila ka tlyenë dhe e djeg shumë e bën shkrumb. Pastaj e kullon me një kulluesë të shpeshtë. Lëngu që bie në gotë, me ndihmën e pendlës së pulës e lyen plagën, pacienti shërohet dhe gjurmët e lëkurës së djegur zhduken.
Mënyra e katërt: Mënyrën e katërt të shërimit e gjejmë në Fletoren e Halil Rogaqit dhe ka këtë përmbajtje:
Duhet me e pre një pulë të zezë, krejtësisht të zezë dhe me gjakun e saj të lyhet plaga e djegur.
Mënyra e pestë:
Djegien e shëron edhe kërmilli, përaktësisht jargët e tij.
Mënyra e gjashtë: Në momentin e djegies, duhet të marrim qumësht të ftohtë dhe t`ia qesim plagës.
Mënyra e shtatë:
Për shërimin nga djegia përdoret edhe i kuqi i vezës dhe pasi të zihet ajo, duhet imtësuar atë dhe mëpastaj i hudhet zejtin. Pasi t`i përziesh e lyen plagën.
Pulën e zezë, krejtësisht të zezë, si mënyrë shërimi e hasim edhe në shërimin e sëmundjeve të tjera dhe siç porosiste Halil Rogaqi, asnjë shtëpi nuk bën të jet pa një pulë të zezë.
Kësaj radhe gjaku i pulës së zezë përdoret për dhëmbët e fëmijëve. Që fëmiu të ketë dhëmbë të shëndosh dhe njëkohësisht të mos ketë dhembje dhëmbi, tradita popullore, përkatësisht në Fletoren e Halil Rogaqit gjejmë këtë shënim:
Me gjakun e pulës së zezë, duhet që fëmisë me ia lyer dudat e dhëmbëve.
Kundër sëmundjes së erës Një sëmundje e shpeshtë, ishte edhe era e cila te pacienti shfaqej nëpërmjet dhembjes së dhëmbëve, skuqjes së fytyrës, lotimit dhe kruarjes së fytyrës.
Ka tre lloje të erës; era e zezë, e kuqe dhe era e bardhë.

Shërimi i kësaj sëmundjeje ishte nga thesari ,,frymorë''. Mjeku fryente në drejtim të pacientit me një frymë të theksuar dhe shqiptonte disa fjalë që luftonin erën me kërkesë që të ,,vinin disa qiragjinjë dhe erën ta dërgonin në një mulli e nga mulliri ta dërgonin në detëra''. Nga kjo kuptojmë se era, nëpërmjet luginave vie nga deti dhe atakon fytyrën e njeriut dhe gjithsesi duhet që ajo të kthet në det.

Mënyrë tjetër:

Kundër erës është përdorur edhe hudhra dhe pasi ta fryejsh atë, pacientit ia prekë fytyrën. Ne nuk arritëm ta mësojmë mënyrën e ,,frymës''!

Në hulumtim të trashëgimisë mjekësore në trevën e Hanit të Elezit, krahas shërimit të sëmundjeve që i trajtuam më lartë, gjetëm edhe mënyra të tjera shërimi nga sihri (magjitë),, i cili i ka bërë njerëzit që të dalin malit'' siç thotë populli. Aq shumë njerëzit kanë vuajtur nga sihri saqë kjo temë meriton një trajtim specifik. Si pasojë e tij, janë ndarë çiftet martesore, kanë pësuar çrregullime familjare, mendore e të ngjajshme sa që populli thotë,, mos të sprovoftë Zoti me të''. Sihrin e bëjnë njerzë që kanë shitur shpirtin e tyre tek djalli. Njerëzit e ballafaquar me këtë lloj sëmundje, kanë provuar mënyra të ndryshme shërimi dhe një mënyrë shërimi nga sihri, kundër sterilitetit, e gjejmë edhe në Fletoren e mjekut popullor Halil Rogaqi.

Mënyra e parë:

Një ditë para ditës së Shëngjergjit duhet me mbledhur lule. Pasi t`i mbledhim lulet, duhet që të nesërmen në mbrëmje, çifti të lahet me ujin e luleve, pra në natën e Shëngjergjit dhe ky shërim në Fletoren e Halil Rogaqit mban numrin 4.

Nga vetë përmbajtja e shërimit, vërejmë se kjo traditë e shërimit është e vjetër dhe ndërlidhet me Shën Gjergjin.

Mënyra e dytë:

Në Fletoren e Halil Rogaqit, ky shërim mban numrin 9 dhe ka këtë përmbajtje:

Që gruaja të ketë fëmijë dhe të mposhtë sihrin, duhet të veproj kësisoji:

Merr lesh ujku, një kokë të miut, tri kokrra krip, tri kokrra grurë dhe tri kokrra elb. Gruaja që nuk ka fëmijë duhet që këto elemente, në mes të natës, t`i fus, t`i mbështjellë në shtat katë mushamë dhe pastaj t`i vendos në trup dhe t`i mbaj deri në shtatëzaninë e saj.

Mënyra e tretë: Gruaja që ka fëmijë, me mbledhë lule një ditë para natës së Shëngjergjit, ndërsa me e la atë guran që s`ka fëmijë natën e Shëngjergjit. Pra lulet që mbledhen duhet t`i fusim në ujë, në një enë me të cilën do të lahesh.Ky shërim në Fletore mban numrin 4

Mënyra e katërt:

Duhet gjetur lëkurën e shqarthit (kafshë grabitqare më e vogël se dhelpra, me gëzof të çmueshëm, zakonishtë me ngjyrë të murme, që ngjitet me shkathtësi nëpër pemë dhe ha pulat) dhe pastaj ta lajsh atë në një enë. Ujin e lëkurës së shqarthit ta pishë. Fletorja numër 42

Mënyra e pestë:

Gruaja që nuk ka fëmijë, duhet ta gjejë një lëkurë të gjarpërit dhe pastaj e vendos në kazanin e mbushur me ujë, pastaj çifti lahen, ndërsa lëkurën e gjarpërit e mbështjell në një arrn dhe e vendos në trup. Lëkurën e mbështjellë të gjarprit e mban në trup deri në shtatëzëni. Në Fletoren e Halil Rogaqit ky shërim mban numrin 42.

Mënyra e gjashtë:Duhet që me një qepë në dorë me u sjellë rreth bunarit, pastaj qepën e len tërë natën te bunari dhe të nesërmen e hanë. Ky shërim në Fletore mban numrin 43.

Jo rrallë ka ndodhur që pasi i zoti i shtëpisë martonte të birin dhe i gëzohej martesës, në natën e dhëndrrisë shpërthenin të zezat në familje. Te burri i sapomartuar si pasojë e sihrit, shfaqej impotenca dhe s`mundte të ,,flinte'' me gruan e tij. Këto sëmundje jo vetëm që kanë ndodhur në të kaluarën, por këto ndodhin edhe sot e kësaj dite.

Në Fletoren e Halil Rogaqit ky lloj shërimi përmban numrin 24 dhe ka dy mënyra shërimi:

Mënyra e parë:

Duhet me marrun dheun e shtatë udhëve dhe këtë dhe të mbledhur prej shtatë udhëve, ta shtrijsh nën dyshek ku flejnë burri e gruaja.
Mënyra e dytë: Duhet t`i blesh 40 dryrë dhe në 40 dryrë të qesësh ujë. Uji që del nga dryrët, duhet që t`a pijë i sëmuari.
Ka ndodhur, që në ditën që është caktuar ,,vadja'' e martesës së vajzës, nëna ka lidhur një nyje në ,,ushkur'' të dimijave dhe e ka zgjidhur atë, në natën e martesës. Kjo metodë ka shërbyer si preventivë, përkatësisht bllokim ndaj sehirebërësve për t`i bërë keq të sapomartuarëve.
Mënyrë tjetër: Momenti që një grua i sheh dy bolla duke u mbarësuar, duhet të heq skutaqen (përparse që e kanë bajtur gratë përpara, pshtjellak) prej trupit dhe duhet t`ua qes bollave, ata menjërend ndahen. Kjo skutaqe më pastaj ka shërbyer për shërimin e personave(burrë e grua) nga ,,lidhja''. Kur të bien të flejnë, ata duhet që skutaqen ta vendosin mbi trup dhe shërohen, ,,zgjidhen''. Ndërsa burrat, kur takojnë bollat në momentin e mbarësimit, mund të hudhin mbi ato faculetën, kësulen, pallton apo diçka të ngjashme.
Mënyrë tjetër: Që i sëmuari të shërohet nga ,,lidhja'' duhet vepruar edhe në këtë mënyrë. Natën, i sëmuari shkon te një parmendë ose pllug që është në arë dhe urinon mbi atë. I sëmuari shërohet nga ,,lidhja''.

Këmisha e preme

Jo rrallë, ka ndodhur dhe ndodhë që nuses apo vajzës së fejuar, si pasojë e sihrit, i prehet këmisha dhe nuk dihet nga kush. Mënyra e shërimit është kjo:
Kur ndokujt i prehet këmisha dhe personi dyshon për sihër, këmisha e preme i jepet dikuj që nuk e sheh të premen, ta zëmë ndonjë personi si ndihmë, por nuk i tregon as qëllimin as arsyen, ose këmishën duhet ta hudhësh në lum.

Zbulimi i fshehtësive

Në kërkim të mjekësisë popullore, gjetëm edhe diçka interesante, madje që bie në domenin e fushës së kriminalistikës, përkatësisht zbulimeve të sekreteve shpirtërore të njerëzve.

Këtë zbulim fshehtësie e gjetëm të shkruar në Fletoren e Halil Rogaqit dhe mbante numrin 33.
Për të zbuluar sekretin, ,,hetuesi'' duhej t`i gjejë këto mjete zbulimi: një sapun, një krehër dhe një pasqyrë. Këto mjete zbulimi, duhet që natën, tinëzisht, të futen nën jastakun e njeriut që fle. Njeriu që fle, nën ndikimin e këtyre mjeteve zbuluese, do të filloj të flas në gjumë dhe ,,përgjuesi'' dëgjon sekretet e atij.
Kundër rënies së flokëve Një natyrë tjetër shërimi e që është përdorur në trevën e Hanit të Elezit, është edhe shërimi nga rënia e flokëve, si pasojë e sëmundjes dhe kemi identifikuar dy mënyra shërimi:
Mënyra e parë:
Për burrin që është ,,kros'' apo qeros (që i kan rënë flokët), sëmundja shoqërohet me të krujtura, puçërra. Duhet të marrim mjaltë dhe gjethe të duhanit kur ai fillon të çelë. Pra, gjethin e duhanit duhet lyer me mjaltë dhe vendoset në kokë. Këtë lloj shërimi e kemi hasur në Fletoren e Halil Rogaqit dhe mban numrin 11.
Mënyra e dytë:
Ka të bëj me vajzën së cilës si pasojë e sëmundjes i kanë rënë një pjesë e flokëve derisa i duket lëkura e kokës. Ilaqi popullor për këtë sëmundje është ky:
Merr hudhra dhe i vendosë në një shishe zejtini e cila është e mbushur me zejtin. Hudhrat i mban të mbyllura në shishe 40 ditë. Pas kësaj, me lëngun e krijuar e lyen kokën ditë me radhë dhe flokët fillojnë të dalin.
Për shërimin e rrebullit
Në sëmundje tjetër e që shfaqej tek fëmijët është sëmundja e Rrebullit. Në konsultim me Fjalorin e gjuhës shqipe, gjejmë se ,,Rrebulli shfaqet në formën e dregëzave me qelb e të cilat u dalin foshnjeve në kokë dhe në faqe, ‘‘rrebulli i fëmijëve''.
Për shërimin e rrebullit përdoret forma e ,,frymës'' në pomadë, sapun e të ngjajshme. Rrebulli i fëmijëve shërohet me ndihmën e numrave duke filluar nga më i madhi njëshifëror e deri te numri fillestar, është ,,frymë'' matematikore.

Mënyrë tjetër:
Për shërimin e rrebullës, përdoren edhe mënyra të tjera, varësisht prej mjekut. Në këtë rast veprohet me maje të gjilpërës duke e lëvizur mbi tokë ose tepih, pastaj kthen gjilpërën në anën e kundërt, duke e lëvizur si në veprimin e parë, në të njëjtën mënyrë vepron edhe në një tabëll të mbushur me hi, pastaj vepron mbi pomadë me ,,frymë'' dhe me gjilpërë. Nuk arritëm ta mësojmë ,,frymën'' për shërimin e kësaj sëmundje.
Kundër të thatit në trup: I thati në trup në të kaluarën ishte një nga sëmundjet e shpeshta dhe në mungesë të barnave mjekësore, pacienti mjekohej me mënyra popullore. Nga grumbulli i dheut që në livadh i ngritë urithi, merrej dheu dhe pasi formësohej në formë të topthave, fryhej me frymën kundër të thatit e më pastaj fërkohej ai.
Kur goja e fëmisë zbardhohet, mikthohet[16]
Kjo sëmundje e fëmijëve shërohet edhe me,,frymë'' edhe me veprim fizik.
I sëmuari shkon te një vijë uji. Nga vija e ujit e cila ka ujë, këputë tri fije bari dhe barin e këputur e kalon nëpër gojën e fëmisë dhe thua tri herë: ,,Bari në gojë, mykthi në tokë''. Pastaj fijet e barit sërish i hedh në vijën e ujit.
Sqarim: ,,Mykth'' i thonë pjesës së bardhë, në formën e gjizës që fëmijëve iu paraqitet për shkak të sëmundjes.
Për fryerje në bark
Për fëmijët e vegjël të citët fryhen në bark, duhet me e marrë grrysen që kruan magjen e me duar mbrapa duhet vendosur në zjarr derisa të skuqet. Pasi të skuqet grryesja, e merr me duar mbrapa(me mashë) dhe grrysen e skuqur e vendos në kusi të ujit.

[16] Myksht (stomatomycosis) sëmundje fëmijësh. Kjo është sëmundje e gojës. Simtomet: fëmijës i zbardhet gjuha e ngapak edhe goja, andaj s`mund të thithë. Mykshti është emërtim i përgjithshëm për infeksionet e mukozës dhe të indeve nga mykrat. Më gjerësisht shih Abdulla Zymberi,,Nga trashëgimia e Mjekësisë Popullore''

Fëmija duhet të pin ujin dhe të pastrohet me atë. Ky lloj shërimi gjendet edhe në Fletoren me numër 23.

Kundër belbëzimit të fëmijëve

Prej çerdhes së zogjëve e marrim dheun dhe një pjesë e qet në gotën e ujit dhe pastaj e pi bashkë me ujin, fëmija shërohet.

Mënyrë tjetër:E merr zogun e posalindur të pulës dhe ia ofron te goja fëmisë dhe thua tri herë: „Sikur ka çelë ky zog, ashtu u çeltë goja e këtij fëmiu''

Mënyrë tjetër:

Në çastin që zihet hëna, merr brum buke dhe e gatuan një kulaç të vogël dhe e pjek. Kulaçin e pjekur ia jep fëmijës dhe thua tri herë: „ Hana u marrtë, ty goja mos t`u marrtë"!

Për shërim nga Kapërcimi

Një sëmundje tjetër është edhe ajo e Kapërcimit.E merr pulën krejtësisht të zezë dhe e pret para se të lindë dielli. Pasi t`a presësh pulën, ashtu duke kulluar gjak, e mban mbi një shoshë, ndërsa nën shosh, në një koritë, qëndron i sëmuari i cili veshur ka vetëm dy rrobet e brendshme, brekët dhe maicën. Gjaku që bie nga shosha, lanë trupin e të sëmuarit. Pas këtij veprimi, në koritë e qetë pulën dhe rrobet e brendshme dhe pastaj bashkë me gjakun e koritës, pulën dhe rrobet e brendshme i gjuan në një ujë, lumë që ecë.

Mënyrë tjetër: Në atë vend që sëmuhet i sëmuari p.sh. alivanoset, humbë vetëdijën, i rrotullon sytë e veprime të ngjajshme, duhet ta marrësh një gozhdë dhe ta vendosish në vendin ku është sëmurë fëmiu. Pastaj e merr fëmiun dhe e kalon nën këmbët tua treherë mbrapa- para duke thënë: „ Si të kam pa, mos të pafsha më''! Kështu veprohet kur fëmiu sëmuhet për herë të parë.

Personi që e sheh për herë të parë fëmiun që është i sëmurë, vepron në të njëjtën mënyrë si më lartë, por për dallim derisa e kapërcen fëmiu nën këmbë para- mbrapa, ia heq këmishën së prapthi dhe thua me fjalë: „Ta ktheva këmishën prap edhe sëmundja mos t`u ktheftë prap''!

Kundër bronkitit: Fëmiu që ishte i sëmurë në mushkri, merrej një letër dhe ajo shpohej shpesh me gjilpëri. Pasi të shpohej

dendur, merrej mjalti dhe lyhej letra e pastaj vendosej në gjoksin e fëmisë.

Për frikë(tutë) Merren tri kafshata të vogla buke dhe pas shpine i mban me duar i sëmuari. Dikush tjetër nga familja e sjell qenin pas shpinës së të sëmuarit dhe qeni merr bukën nga dora e të sëmuarit. I sëmuari pa e kthyer kokën mbrapa, shqipton me fjalë: - ,, Sa e pash qenin tuj hangër këta copa buke, aq paça frikë unë '' dhe largohet në një drejtim të kundërt me qenin, pa e kthyer për asnjë çast kokën prapa.

Ka edhe mënyra të tjera shërimi nga frika. Pacienti shkon te mjeku popullor dhe ai i fryen ujë me të cilin edhe e pinë edhe i lanë faqet e fytyrën.

Për frikën te fëmijët nga një shëruese tjetër gjetëm edhe një mënyrë ndryshe nga kjo e para:

Edhe ky shërimi bëhet me ujë e ,,frymë'' por njëkohësisht duhet që pacienti të thirret në emër, por ai nuk duhet të përgjigjet. Në fund, me ujin që e kemi fry paraprakisht laget zverku dhe gropëza e qafës.

Në udhëtim të hulumtimit të shërimit nga sëmundjet e ndryshme, gjetëm edhe një mënyrë tjetër dhe tejet interesante, shërimin nga **Shndërrimi, shitimi**.

Plaka me një përvojë 60 vjeçare të fryerjes, tha se deri më tani kam shëruar mbi 40 fëmijë të cilët ishin shndërruar, ishin shituar, nuk ishin më si kanë qenë, nuk i përngjanin më vetëvetës, sytë nuk janë ato që i ka pasur më parë, me një fjalë fëmija tjetërsohet, sepse të vërtetin e kanë marrë të ,,tjerët'', ,,zanat" dhe ai duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme, por si?

Shëruesja tha se që në fillim, duhet t`u sqarohet prindërve se fëmija edhe mund të vdes në momentin e frymjes sepse është sëmundje e rëndë!- Në të gjitha rastet që kam pasur tha ajo, prindërit janë pajtuar duke thënë se ashtu kështu, fëmija është në prag të vdekjes dhe se kjo është shpresa e fundit. Në fakt, nuk kam dëshirë të përballem me një rast të tillë, por ja që njerëzit ta zënë derën dhe s`ke kah t`ia mbash. Fëmija duhet të nxjerret natën në oborr, ditën e hënë në mbrëmje, të shtrirë në djep dhe me zë

kërkon nga ,, të tjerët'' që të kthehet fëmija i vërtetë. Dhe kur dëgjohen të qajturat e fëmisë në djep, atëherë e kupton se shërimi mori fund, por nëse fëmiu nuk qan, atëherë vdekja e tij është e pashmangshme. Jam bërë sebep t`i ,,ngjalli'' mbi 40 fëmijë të tillë, tha ajo.

Një mënyrë tjetër kundër Shndërrimit është edhe kjo:

Merr një gjykim me ujë me afërsisht 2 litra dhe e vlon, pastaj ujin e vluar e vendosë në një vorbë dhe e vlon edhe një herë. Pas këtij veprimi, ujin e vluar e vendosë në një tepsi paksa të thellë dhe prej tepsisë ujin e vendosë në një shishe dhe nga shishja e lanë tërë trupin e fëmisë në një koritë. Në fund merr ujin e koritës dhe ia qet një peme që po rritet. Kjo mënyrë shërimi ka edhe frymën e sajë, por ,,frymën'' nuk kemi arritur ta sigurojmë.

Kundër dhunës dhe frikës policore

Në hulumtim të shërimit popullor, gjetëm edhe një veprim tjetër me interes. Shqiptarët të pa shtet e të pushtuar që ishin, jo rrallë ftoheshin nga pushteti gjakëpirës në xhandarmëri e në polici. Që viktima (shqiptari) të kalon më lehtë nga duartë e pushtuesit, mjeku popullor kishte paraparë një ,,frymë'' kësisoji:

Merrte një penjë të gjatë dhe e këndonte Tespih dovën dhe pas një këndimi e lidhte një nyje. Kështu vepronte 72 herë dhe i lidhte 72 nyje dhe ia jepte viktimës i cili e fshihte brenda rrobeve. Shpresohej që hetuesve policor, t`u lidhej goja dhe viktima të kalonte më lehtë nga duartë e tyre.

Kundër dregëzave: Mënyra e parë: Duhet me i marrë 7 gurë dhe me ato gurë me i prekë dregëzat, pastaj gurët i vendosim nën një gur të madh dhe i mbulojmë me dhe që të mos shkelen. Fletorja nr. 50

Mënyra e dytë:

Mbledh Luleujëse ose lulen Katërjum dhe pasi të thahet nën hije, e bluan. Pastaj e qesëm në një tigan dhe i qet tlyen dhe e shkrumbon. Këtë lëndë të përzier pastaj e kullon dhe më lëngun e saj e lyen dregëzën ose plagën.

Mënyra e tretë:

Kjo lule përdoret edhe si çaj dhe është e mirë për ftohje, veshkë dhe dezinfektim.

Mënyra e katërt:

Lulen e futë një një shishe 1 litërshe të zejtinit(vajit ushqimor) dhe në këtë gjendje e mbajmë 40 ditë. Është shëruese për dregëza, djegëje, prerje dhe majesil.

Për shërimin e lythave: Gjejmë fije të njomë fieri. E presim kërcyllin e fierit në disa vende prej të cilit del njëfar lëngu si qumësht. Me këtë lëng e prekim lythin e dalun, disa herë. Pas kësaj, lythi fillon përrreth të skuqet dhe pas disa ditëve lythi bie vetvetiu.

Për imunitet„ kuvet''

Një sëmundje që jo rrallë paraqitej te banorët e kësaj treve, ishte edhe humbja e „kuvetit'', humbja e forcës, humbja e imunitetit. Ndër faktorët kryesor të humbjes së imunitetit ishte edhe vet jeta e rëndë e femrës shqiptare, ushqimi i dobët dhe jo kalorik i saj. Në fletoren e Halil Rogaqit, shërimi i kësaj sëmundje bartë numrin 9 dhe shërimi i saj bëhet në këtë mënyrë:

Duhet të marrim gjethet e arrës dhe pasi t`i ziejmë ato, duhet të pijmë lëngun e gjetheve.

Për gratë anemike

Për gratë që janë anemike, por edhe për burra, mënyra e shërimit është kjo:

Marrim gjethet e arrës kur çelin dhe i ziejmë. Pas zierjes pimë lëngun e gjetheve. Koha e përdorimit të tyre është 40 ditë pandërprerë. Edhe kjo mënyrë e shërimit është në Fletore me numrin 31.

Kundër dhembjes së gjirit të grave

Merr spec djegës e zien në ujë dhe pastaj e len ujin që të ftohet. Me këtë ujë e pastron gjirin për disa ditë. Ky shërim në Fletore mban numrin 44.

Për "Kokë të mirë"

Për shërim nga "Koka e mirë", përdorej drapëri i cili skuqet në zjarr dhe me drapërin e skuqur djegen lehtë tri unazat e qafës. Nëse djegëja nuk është profesionale, pacienti verbohej.

Kundër të dunmes

Nga punërat dhe peshat e rënda, burrat dhe gratë, duneshin. Kjo sëmundje shërohej në këtë mënyrë. Në mbrëmje, pacienti ofrohej te pragu i derës së dhomës dhe shëruesi e ngrite dhe e shkundte me kokën poshtë.

Për reumë Krahas sëmundjeve të tjera që ishin të shpeshta dhe kërkonin ,,derman'', ishte tepër prezente edhe sëmundja e reumatizmës. Për shërimin e saj në Fletoren e Halil Rogaqit, thuhet se:

Duhet të marrim një shishe dhe atë e fusim nën tokë, në rrënjët e arrës. Shishen nën tokë e vendosim në Shmitër (8 nëntor) dhe e mbajmë nën tokë deri në Shëngjergj. Në Shëngjergj e nxjerrim shishen të mbushur me lëngun e rrënjëve të arrës dhe pastaj e lyejmë trupin.

Për shërimin e pikës së zezë në shputën e këmbës

Kjo sëmundje paraqitet në shputën e këmbës, më së shumti në shputën e gishtit të madhë dhe duket sikur në këmbë ke ndonjë ferrë. Çdo herë që tenton me gjilpërë me hjek ,,ferrën'' ajo futet edhe më thellë.

Shërimi i saj bëhet me kërmill. Pasi të gjesh kërmillin me gëzhojë, e përgatitë këmbën dhe me shpejtësi me mishin e kërmillit e prekë plagën tri herë dhe përsëri kërmillin e vendos në pozitën siç e ke marrë. Krahas veprimit fizik, është edhe veprimi,,frymorë'' dhe duhet të thash tri herë: - Hjeke mish, mishin!Bari shërues është jarga e kërmillit.

Kundër tartabiqeve

Tartabiqet janë kandërra të vogëla me trup të rrumbullakët e të shtypur, me ngjyrë vishnje të errët e me një erë të rëndë. Jetojnë si parazit në banesa, nëpër plasa a vrimat e mureve, të dërrasave, të shtretërve etj. ose në vende të errëta dhe që u thith njerëzve gjakun kur flenë; çimkë. (Fjalori i gjuhës shqipe)

Që të shpëtojmë nga tartabiqet, në Fletoren e Halil Rogaqit me numrin 22 gjejmë këtë mënyrë eleminimi;

Merr gjysmë litre maje uthulle dhe uthullën e vendosë në mes të dhomës. Mbyllë derë e dritare dhe kështu të mbyllura i mban 24 orë. Tartabiqet zhduken.

Kundër hermoroideve

Për shërimin nga hermoroidet përdoren rrënjët e hithrës. Nxjerret hitha nga toka, i hiqet dheu dhe zihen rrënjët e hithrës. Pas zierjes lëngu i hithrës pihet.

Mënyrë tjetër:

Merr fletën e qepës ose të preshit dhe i vendosë mbi shporet të nxehtë, që të zbuten. Fletën e lyen me zejtin ose tëlyen të nxehtë dhe e vendosë në zorrë të trashë.

Mënyrë tjetër:

Merr arra të vogla, të sapoqelura dhe i shtyn të paqëruara në vaj të ullirit. Pas kësaj e lyen zorrën e trashë.

Kundër tuberkulozit

Sëmundja e turbekulozit në të kaluarën ishte vdekjeprurëse. Edhe nga kjo, njerëzit nuk rrinin duarkryq; analizonin dhe zbulonin mjete të ndryshme shërimi. Një i tillë është i shkruar edhe në Fletoren e Halil Rogaqit me numrin 45 dhe ka këtë përmbajtje:

Gjysë kilogrami mjaltë edhe gjysmë litre raki 30 gradëshe, 9 limona edhe 9 vezë. Të gjitha këto, përzihen dhe i vendosim në një enë dhe ia zëmë mirë grykën dhe e mbajmë të mbyllur 20 ditë me radhë, pastaj lëndën e krijuar e hamë.

Për dhembje gjoksi

Një kilogram mjaltë edhe gjysmë kilogrami presh, pastaj i përziem dhe i hamë , Fletorja nr.47

Për mushkri, frymëmarrje

Merr 1 qep dhe e copton në katër pjesë dhe copat e qepës i qet në një kilogram mjaltë, pastaj e shtrydhë një limon. Këtë e rregullon në mbrëmje, ndërsa e han në mëngjes.

Për frymarrje, variant Merr lulen e arrës(resmën) ende pa krijuar kokërra dhe pastaj e shtyn në 1 kg. mjaltë dhe e len në gjendje të tillë 40 ditë, pastaj e pinë lëngun.

Kundër kollitjes

Merr 2 qepë, 2 limona, 2 molla, 1 litër ujë. Këtë përbërje e zien derisa të mbetet më pak se gjysma e litrës së ujit dhe ia jep që ta pijë personi i sëmurë.

Për shërimin e plagëve nga armët

Për shërimin e plagëve, marrë nga armët si: nga thika, kosa, por edhe nga plumbi, plaga shërohej fillimisht më urinën e personit të plagosur. Vendosej edhe duhan i grimcuar, i imët, pastaj merrej edhe zami i bletës dhe në fund përgatitej melhemi. Kur plaga nga plumbi ishte e cekët përdorej edhe thithja e gjakut nga plaga dhe nëse plumbi ishte afër lëkurës, nxirrej me dhëmbë. Melhemi njihet si mjeti kryesor për plagë dhe është përdorur dhe përdoret shumë ndër shqiptarët.

Melhemi përgatitej në këtë mënyrë:

Merret lëvorja e drurit të shtogut(shtresën e mesme të lëvores) dhe e vendos në tlyen. I përziejmë lëvoret derisa të skuqen. Pastaj e kullon tlyenin dhe i qet një kokërr gurë kali, një copë nishadër dhe limon dhe i përzien derisa të shkrihen dalëngadalë edhe i qet sa të duash tlyen, (me pas tlyen buallice është më mirë), por bën edhe tlyen lope. Pas kësaj melhemi është i gatshëm për përdorim.

Mënyrë tjetër:

Për krijimin e Melhemit, për shërimin e të gjitha llojeve të plagëve ka edhe **mënyrë tjetër**:

Merret 1 kg. tlyen, 10 copë lule të bardha të shtogut kur çelë në pranverë. Pastaj, marrim 1 kg limona dhe i grimcojmë, 1 gurë kali[17], 1 copë nishadër[18], 1 dyll blete(secila nga këto me madhësi sa një copë llokumi) dhe të gjitha këto i qesim në një enë dhe i ziejmë njëorë e gjysmë. Pasi të zihen mirë, i kullojmë. Për shërim

[17] Guri i kalit (gurkali) ose sulfati i bakrit përfitohet kryesisht nga komponimet e bakrit CuSO4. Përdoret për përgatitjen e pesticideve, plehërave artificial që përdoren në bujqësi e sidomos për spërkatjen e rrushit dhe për sëmundje të tjera.

[18] Nishadra është komponim i azotit(N). Nishadra fitohet nëse bashkëvepron me amonjakun, komponim i azotit me acidin klorhidrik ose thartinat që i përdorim për pastrim. Në të kaluarën ka gjetur përdorim në kallaitjen e enëve nga metali, por edhe për luftimin e sëmundjeve të ndryshme.

mund të përdorim edhe pjesa e kulluar që bie në enë, por edhe pjesa që mbetet në kulluese.

Nxjerrja e gjilpërës nga trupi

E nëse ndodhte që gjilpëra të futej në trup, atëherë duhej vrarë një dhelpër dhe pasi të vritej, i prehej gjuha dhe vendosej mbi plagë. Gjuha e dhelprës e tërheq gjilpërën nga trupi.

Shërimi i hepatit(sarillëkut)

Mjeku popullor merrte një zhilet dhe pacientin e prente me maje të zhiletit në ballë, në mes të dy vetullave. Bëhej një prerje e lehtë(tri vija) derisa dilte gjaku. Pas këtij veprimi, mjeku popullor merrte një thelb hudhëre dhe me atë fërkonte pjesën e prerë e cila nxjerrte gjak. Hudhrën me gjak, pastaj ia jepte pacientit që ta hante.

Mënyrë tjetër:

Kundër hepatitit janë përdorur edhe peshqit e vegjël të lumit. Merren peshqit, futen në një enë dhe personi që e ka ,,sarillëkun'' në sy duhet t`i shikoj peshqit dhe nga sytë e tij, ,,sarillëku'' kalon në sytë e peshqve.

Mënyrë tjetër: Kur foshnja e paslindur, vërehet se ka ,,sarillëk'' ateherë trupi i foshnjës duhet të mbështillet me një pëlhurë me ngjyrë të verdhë.

Kundër murtajës, linkimit

Murtaja: Sëmundje ngjitëse shumë e rëndë, që shkaktohet nga një virus i posaçëm, përhapet shumë shpejt, shfaqet me zjarrmi e dobësi të madhe, me dhembje të forta në kokë, në qafë etj.dhe sjell vdekjen. (Fjalori i gjuhës shqipe)

Murtaja ishte një sëmundje e rëndë, vdekjeprurëse dhe kësaj treve është shfaqur në vitin 1568 saqë një udhëpërshkrues kur kalon nëpër Kaçanik shkruan: Edhepse Kaçaniku qenka një vendbanim i bukur, njerëzit nuk shihen askund, që don të thotë se ose i ka zhdukur kolera ose kanë ikur maleve për shpëtim. Në vitet e mëvonshme, kolera kishte goditur edhe Gjakovën dhe për më tepër shih librin e Jusuf Buxhovit ,,Shënimet e Gjon Nikollë Kazazit. Që të shpëtohej qenia jonë, njerëzit, mjekët popullor, nuk

kanë ndejtur duarkryq, janë përpjekur ta sfidojnë atë. Luftonin me atë që kishin. Në terren gjetëm këtë mënyrë kundër kësaj të keqe;
Merrej një pej i gjatë dy pash, dhe një vajzë e re e cila nuk ishte e fejuar, duhej ta pyeste mjekun popullor:
Çka po bën aty?
Po lidhi për(duhet të shqiptohet emri i njeriut që dëshiron të mos sëmuret) që t`mos i bie dergja dhe lidhë një nyje në pe.
Kështu vepron edhe për anëtarët e tjerë të familjes.
Pas kësaj, gjen skrraja për aq anëtarë të familjes që ke lidhë penj, dhe skrrajat, pasi ke hequr të bardhën e vesë, i vendosë në një ve.
Vezën me skrrajat në atë, e vendos në afërsi të oxhakut në një gropë.
Vajza e re e pa fejuar të pyet përsëri:
-Çka po bën aty?
Po e vendos një pulë klluqe dhe vendos disa gurë të vegjël rreth vezës.
Vajza e pafejuar pyet përsëri:
-Çka po bën aty?
Po e vendosë këtë pulë klluqe, kur t`i bjere dergja këtyre skrrajave, atëherë ju raftë dergja edhe fëmijëve të mi dhe merr një gurë në formë rrase dhe e mbulon vezën dhe pastaj e mbulon me hi ose dhe të tërën.
Pas këtij veprimi, mjeku popullor merrte një thupër të gjatë rreth 20 cm, gjente një pëlhurë dhe e mbështjellte thuprën në formë të kukllës dhe e vendoste në një vend kah lindte dielli. Kështu vepronte me thupra edhe për anëtarët e tjerë të familjes. Shpresohej në mbrojtjen e fëmijëve nga murtaja.

Për shërimin e venave të gjakut

Një sëmundje tjetër e cila është shëruar me mjekësinë alternative është edhe ajo e venave të gjakut. Gjendej një lloj skrraje të cilës i thonë,,pijavicë''(ushujzë) e cila jeton në ujëra të nxehta dhe ka ngjyrë të zezë. Ushujza ofrohet te vena e këmbës dhe pasi ngacmohet që të del gjaku, ofrohet ushujza e cila e thithë gjakun e keq.

Ushujza është përdorur edhe për shërimin e syrit, kur gjaku është mbledhur në sy. Ofrohej ,,pijavica'' afër syrit që kufizohet me hundën dhe ajo nxjerrte gjakun e keq.

Trupi në lëkurë dashi

Futja e trupit të sëmuarit në lëkurë dashi, bëhej atëherë kur personi kishte të lënduar rëndë shpinën. Atëherë prehej me shpejtësi një dash, nxjerrej lëkura e tij dhe derisa lëkura është e nxehtë, mbështillej shpina e të sëmurit. Kjo metodë është përdorur shumë ndër shqiptarë. Kjo mënyrë shërimi është përdorur me të madhe gjatë aksionit famëkeq për mbledhjen e armëve në vitin 1956, e njëjta u përdor edhe ndaj dëshmorit Driton Loku dhe të torturuarëve të tjerë para luftës së vitit 1999..

Lakërat e rasojit

Në vitin 1956, klika antishqiptare Tito-Rankoviq, në Kosovë, zbatuan aksioni famëkeq të dorëzimit të armëve dhe nga çdo shtëpi shqiptare kërkohej dorëzimi i armës. Pra, për çdo shtëpi shqiptare, kërkohej arma. E ai që s`kishte çka të dorëzonte, torturohej aq rëndë sa që me javë qëndronte i shtruar në dyshek. Një torturë e tillë në trevën e Hanit të Elezit është bërë edhe ndaj hafëz Sami Bushit i cili për shtatë javë ka qëndruar i shtrirë në shtrat dhe për shërim ka përdorur lakrat e rasojit.

Të mërdhimit, përthojshi

Kur fëmijët, po edhe të rriturit janë mërdhirë shumë në borë, saqë duartë apo këmbët e tij pothuasje janë ngrirë(athur), atëherë nuk merrej uji i nxehtë për larjen e gjymtyrëve, por merrej uji i ftohtë. ,,I ftohti largohet me të ftohtë"!- kështu thoshte mjekësia popullore.

Kundër mësyshit

Mësyshi apo ,,syri i keq'' ishte i pranishëm dikur, por i pranishëm është edhe sot. Mësyshi reagon kundër çdo gjëje të bukur dhe linte pasoja deri në vdekje të fëmisë! Mësyshi është aq i fortë sa që e çanë edhe gurin, thoshte populli. Një ,,Mashallah'' e thanun e eviton rrezikun e mësyshit, por ka edhe mënyra shërimi të tjera.

Fuqia e syrit

Gjatë hulumtimit të mjekimit popullor, njëri nga bashkëbiseduesit e mi më tha: Duke shkuar për Shkup, në rrugë na doli një gjarpër i trishtueshëm. Bashkëudhëtari im nga Bllaca më tha: A dëshiron ta plasë këtë gjarpër që po e shohim?! Pas shikimit të thellë që ia bëri gjarpërit dhe pas disa fjalëve që i shqiptoi e që unë nuk i mora vesh, gjarpëri vërtetë plasi. Këte e kam parë me sytë e mi!

Se fuqia e syrit ishte e madhe, flet edhe një ngjarje tjetër: Njëri i kishte pasur dy kuaj të mirë. Derisa po udhëtonin duke tërhequr qerren, ai që merrte mësysh i tha shokut të tij: Shiko kur t`ia çrregulloj kuajt! Dhe vërtetë kuajt nisën përnjëmend të çrregullohen. Atëherë i zoti i kuajve, duke ditur se kuajt i mori mësysh dikush, kishte ditur mënyrën e kundërveprimit, menjëher filloi t`i pështurr kuajt me urinën e vet dhe kuajtë u çetsuan.

Ka raste kur as vet njeriu nuk e din që merr mësysh. Njerëz që marrin mësysh janë ata që kanë thithur gjirin e nënës gjatë kohë, më shumë vjet, se që është zakon; ose (edhe më shpesh) ata njerëz të cilët e kanë lënë njëherë gjirin e nënës dhe mbas një kohe kanë filluar të thithin përsëri.[19]

Në mbrojtje nga mësyshi ka shum mënyra, dominon mënyra e shërimit nga mësyshi me anë të ,,frymës'' ndaj të sëmuarit me ,,adete'' popullore duke i shqiptuar disa fjalë si:,, Tri çika në sokak, krejtë i kanë parë dhe krejtë janë çuditë, por këtë fëmijën (i përmendej emri) askush se ka parë dhe askush s`është çuditë'' dhe fëmiu që ishte dëmtuar nga mësyshi, shërohej.

Një mënyrë tjetër për shërim nga mësyshi e gjejmë edhe në Fletoren e Halil Rogaqit numër 17 ku thuhej se:

,,Vetëm nëse dyshon se syri i keq po ta dëmton fëmijën apo kafshën, me dorën tënde preke organin tënd mashkullor dhe pastaj fërkoja sytë fëmisë ose kafshës''. Kundër mësyshit, në Fletore nr.38, gjejmë edhe këtë mënyrë shërimi,, Shkele me këmbë të djathtë njeriun që merr mësysh'' . Një porosi, si preventivë kundër

[19] Mark Krasniqi ,, Nga gurra e traditës'' Prishtinë 1991, fq.199

mësyshit, është zakon të përdoret fjala ,,Mashalla'' para çdo gjëje të bukur.
Mjekët popullor në trevën e Hanit të Elezit, për shërim ndaj mësyshit kanë përdorur edhe librin e shenjtë, Kuranin dhe kjo metodë shërimi përdoret edhe sot e kësaj dite.
Kanë kënduar, në prani të fëmisë, 15 herë suren Vel-Asri dhe 5 herë Ajetul Kursinë.Krahas kësaj, mjekët popullor kanë përdurur edhe këtë thënie:,,MashAllah, la havle ve la kuvete il-la bil-lah'' dhe kanë porositur të tjerët që kur ta hetosh që po të ,,grufllon'' zemra ndaj dikujt duhet thënë ,,MashAllah, la havle ve la kuvete il-la bil-lah''
Mjekët popullor, të cilët shërojnë me Kuran, kanë fry ujë edhe kundër sihrit:
Lexon kaptinën Fatiha 7 herë
Ajetul Kursinë 7 herë
Pesë ajetet e para të sures El Bekare 7 herë
Suren Kafirun, 7 herë
Ihlas, 7 herë
Nas, 7 herë
E fryen shishen me ujë dhe e pastron trupin tri herë në ditë, mëngjes, drekë e mbrëmje dhe ujin që hargjohet e shton. Në këtë mënyrë duhet të veprosh tri ditë radhazi.
Megjithatë shërimi nga sihri është një kaptinë në vete dhe një temë krejtësisht specifike dhe meriton një trajtim të veçantë. Kur po hulumtoja traditën e shërimit popullor, në bashkëbisedim me hoxhën Nexhmedin Dernjani i cili mënyrën e shërimit e ka të trashëguar nga babi i tij Mejdiu, tha se: Janë mëse të shpeshta dhe të rënda sëmundjet e tilla duke karakterizuar dy raste; ndarja e çifteve pa ndonjë arsye të veçantë dhe zhdukja e pasurisë.

Kundër etheve

Mjekët popullorë që kanë shëruar me Kuran, për shërim nga ethet kanë lexuar Kaptinën e Kuranit, Elem Tere Kejfe 3 herë.
Por, kur ndodhnin përmbyetje tokësore e tërmete, mjekët popullorë kanë porositur që të lexohet duaja e profetit Junus:
La ilahe il-la ente Subhaneke inni kuntu minedh-dhalimin.

Për të pamartuarit, që nuk kanë kësmet

Në të kaluarën krahas sëmundjeve të ndryshme, problem paraqiste edhe zënia e nuses(fejesa), andaj për djalin apo vajzën që s`po i vinte kësmeti, zbatohej kjo mënyrë veprimi:

Duhet me i mjelë 9 dhi, e në qumshtin e tyre me i qitë disa gjethe me katër lapa të tërfojës, e pastaj atë qumshtin e pinë, Fletorja nr. 7

Kundër çmendurisë

E merr mbeturinën e qenit të bardhë, e pjekë në shporet ose zjarr dhe e shtyp e bën pluhur. Pasi të bëhet pluhur e qet në kos dhe e përzien, pastaj ia jep të sëmurit. Pas këtij veprimi, të sëmuarit duhet me ia shkye rrobat e veta dhe me ia lënë në mes të rrugës. Fletorja nr.20

Për të krupit[20] Fëmija që kropitet ka dhembje barku, i vjen të vjellë, dehidrohet dhe siç thonë mjekët popullorë,, lodhet me shpirtë''

Merret një gotë me ujë dhe një lugë të cilën e përdorim për ngrënie. Shkon te oxhaku dhe e rrafshon hirin dhe pasi ta rrafshosh atë, me lugë i bie hirit duke i lënë 9 shenja (forma) të lugës. Pasi kanë mbetur 9 shenjat e lugës në hi, atëherë fillon nga shenja 1, merr pak hi prej kësaj shenje dhe e futë në gotën me ujë dhe thua: -Hiqe krup t`kruptin, pastaj vazhdon te numrat tek 3, 5, 7, 9 dhe prej secilës shenjë merr hi dhe vendos në gotë duke e përsëritur ,,frymën'', Pasatj nga numri 8,6,4,2, pra numrat çiftë duke marrë hirin prej secilës shenjë të lugës dhe duke i përsëritur fjalët,, hiqe krup t`kruptin''. Në fund e pin ujin që gjendet në gotë dhe fëmija shërohet.

Mënyrë tjetër:

Pacientit i fryen ujë dhe ia jep me pi. Nuk arritëm ta mësojmë mënyrën e ,,frymës''.

Mënyrë tjetër:

Në llërën e pacientit, nën dhe mbi atë, fërkohet me fletë qepe.

Kundër shtypjes

[20] Krupi- që të nxit të vjellët, neveri

Kur një person ka shtypyr ndonjë gjymtyrë, atëherë merrej qepa dhe shtypet e pastaj i qet zejtin e krip dhe vendoset në plagë dhe mbahet tërë natën.

Kundër temperaturës Kur fëmiu ka temperaturë, duhet përdorur uthulla. Me uthull lyhen pjesët e trupit, sidomos këmbët.

Për asht (koc) të vdekur

Shërues për këtë sëmundje është fëmija i cili ka lindur pasi i ka vdekur babai. Ky person është shërues i ashtit të vdekur që del në vende të ndryshme të trupit. Mjafton që vetëm me gojë ta ,,kafshon'' ashtin dhe ai zhduket.

Kundër lishave Lishat që dalin në gjymtyrë shërohen në këtë mënyrë: Merr një gjilpërë, (kokën e gjilpërës) dhe e ,,shpon'' lëkurën e lishës në formë rrethi dhe pastaj gjilpërën e ngulë në tokë.

Mënyrë tjetër: Dunjët e njomë që dhezen në zjarr, ata gjatë dhezjes lëshojnë lëng. Me lëngun e këtij druri lyhet lisha.

Epilogu i kësaj njësie hulumtuese

Thesari i kulturës popullore është një mozaik i pafund i përbërë nga një mori elementesh të ngjyrave të ndryshme të kulturës materiale dhe shpirtërore të traditës sonë. Etnografia ka për detyrë që me kujdesin më të madh të hulumtojë, të studiojë dhe ta ruajë çdo element të tillë që të mos zhduket pa gjurmë në valët e jetës moderne duke i bërë kështu shërbim të madh kulturës e shkencës kombëtare dhe asaj botërore.[21]

Në kuadër të këtij thesari popullor, bënë pjesë edhe mjekësia popullore, si trashëgimi shpirtërore, krahas dokeve, zakoneve, lojërave, këngëve e mërëdhënieve ndërmjet njerzëve.

Me vdekjen e gjeneratave më të vjetra, natyrisht se po zhduket edhe kjo pasuri shpirtërore, po zhduket një pjesë e kulturës shqiptare, po humbet një pjesë e mënyrës së të jetuarit e brezave në këtë trevë.

[21]Mark Krasniqi "Nga gurra e traditës'' Prishtinë 1991, fq.24

Ne u munduam që këtë pjesë të kësaj trashëgimie ta mbledhim, analizojmë, sistemojmë dhe arkivojmë në formë libri. Pavarësisht se sa „jashtë kohore'' mund të na duket kjo trashëgimi e mbledhur, ajo flet për mënyrën e jetesës e mbijetesës së banorëve të kësaj treve, flet për mënyrën e shërimit të njerzëve tanë nëpër shekuj. Ky brum shpirtëror i mbledhur dhe kjo lëndë që tani është e arkivuar në formë libri, duhet të shërbejë për trajtim të mëtejmë për mjekësinë moderne si kirurgjia, pediatria, stomatologjia, fusha sociologjike dhe gjithsesi ajo e psikologjisë.

Se sa shumë është përdorur, nëpër kohë e periudha të ndryshme mjekësia popullore në trevën e Hanit të Elezit, nga një anketë spontane e zhvilluar brenda një familje prej 7 anëtarëve, doli se 4 prej tyre kishin qenë së paku një herë te mjeku popullor e që don të thot se mjekësia popullore është ende aktuale.

Atëherë, cilët janë faktorët që ndikojnë që ky ,,relikt'' popullor të përdoret ende, edhe në fillim të shekullit XXI?

Mendojmë se përdorimi i gjatë i mjekësisë popullore në të kaluarën, është ngulitur thellë në mentalitetin e banorëve të kësaj treve dhe nuk hiqet lehtë nga kujtesa popullore. Por, edhe disa sëmundje më specifike si mësyeshi, sihri, të shituarit, era, përdredhja, tuta (frika), të kapërcimit, apriori sikur janë të destinuara për mjekun popullor.

Nëse një person djeget me ujë të vluar, edhe nëse viziton QKMF-në, mendjen e ka te mjeku popullor, pasiqë me barna popullore është vërtetuar se shenja e të djegurës nuk të mbetet në lëkurë.

Gjatë hulumtimit të shërimit popullor, në terren, kemi identifikuar këto mënyra shërimi:

Shërim me „frymë''- mjeku popullor si mjet shërimi përdor vetëm frymën, duke i lexuar disa fjalë, të cilat nuk mund t`ia kuptojë pacienti dhe pas çdo fjale, fryen në drejtim të tij.

Shërim me veprim fizik, mjeku përdorë mjete e gjësende të ndryshme, varësisht prej sëmundjes.

Shërim i kombinuar, ky lloj shërimi, me frymë dhe me veprim fizik, është më i përhapur dhe më dominues.

Shërim me bimë, shërim me lëngun e këtyre bimëve.

Shërim me lexim të Kuranit, shërim mjaftë specifik, këtë e bëjnë zakonisht hoxhallarët dhe përdoren ajetet e librit të shenjtë Kuranit.

Gjatë hulumtimit të shërimit popullor, gjetëm se shëruesit në ,,zanatin'' e tyre kishin përdorur këto mjete: Gjilpërën, thikën, grihën, fshesën, gurkalin, nishadrën, thundrën e kalit, qumështin, uthullën, hirin, vajin, mjaltin, shtogun, lulet, sapunin, krehërin, pasqyrën, pomadën, dheun, duhanin, urinën, krusen e magjes, qepën, preshin, vezën, mushamanë, frymën, Kuranin, ushkurin, pulën e zezë, drurin e njomë, fierin, lakrën, skrrajën, rërën, kinlat, gjethet e arrës, tlyeni, fijet e barit, pendla e pulës, hudhra, lëkura e ujkut, lëkura e shqarthit, gjuha e dhelprës, këmisha, kërmilli, lëkura e gjarprit, uji, shosha, korita, peri, etj.

Të gjitha këto lloje dhe mjete të shërimit, për qëllim kishin shërimin e të sëmuarit, e në anën tjetër në kulturën popullore, ky lloj shërimi e begaton edhe më shumë trashëgiminë kulturore në trevën e Hanit të Elezit, andaj besojmë se edhe ia kemi arritur qëllimit fundamental: mbledhjes, analizës, krahasimit, arkivimit dhe prezantimit të këtyre vlerave.

Pavarësisht se sa u dëmtuan këto vlera gjatë viteve, dekadave e shekujve, katundi, përkatësisht fshati, arriti që t`i ruaj shumë vlera kulturore, të cilat disa prej tyre janë të gjalla edhe sot dhe do të mbeten objekt trajtimi e studimi edhe në të ardhmen.

Gjurmëve të vlerave etnomuzikore në trevën e Hanit të Elezit[22]

Gjatë shekujve, treva e Hanit të Elezit ka kultivuar dhe kapërcjellur tek gjeneratat e më pasme një traditë të pasur të

[22] Një pjesë e këtij shkrim, nga autori Shaban Çupi, është botuar edhe në monografinë Shoqëria Kulturore Artistike ,,Sharri'' në vitin 2014

vlerave të trashëgimisë sonë kulturore duke përfshirë ato:arkeologjike, arkitekturale, etnologjike edhe muzikore.
Banorët e kësaj treve, rritur e plakur nën pushtime të huaja, janë munduar të kenë një sistem të veçantë të jetës së tyre, sistem ky, jashtë rrethojës ligjore të pushtuesve. Ata duke mos hequr dorë nga përkatësia e tyre iliro-shqiptare, me të vetmen armë që kishin, pra gjuhën e bukur shqipe, thurën këngë e valle. Natyrisht, herë fshehur e herë hapur, ruanin, kultivonin dhe përcjellin tek brezat e rinj prushin e etnosit shqiptar e bashkë me te edhe një trashëgimi të gjithanshme nga e kaluara jonë.
Të parët tanë me lahuta, sharki, çifteli, defa, kavalle…e fyejt që i gdhendnin vetë, në mes të odave tona, me burra të fjalës e besës, plisbardhë e bujar, të veshur në tirq, brez (shokë), jelek e xhamadan këndonin këngët e asaj kohe të pakohë e cila për shqiptarin çdo herë ishte me stuhi. Këndonin edhe këngë arshikie, por s`harronin të këndonin edhe për ata që ranë për të mos vdekur kurr për këtë truall arbënor të cilin ua kishte dhuruar vetëm Perendia.
Me këngët që ishin përcjellur brez pas brezi, këndonin këngë të ndryshme, misid tjerash ajo; e Shaban Bushit kundër zaptive turke; këngën e Avdi Hysës vrarë nga cubat e Cetinjes, këndonin dhe mallkonin Novicën e zi i cili shkrumboi familjen e Demë Ahmetit në Llap, këngën e Hasimes, Hasan Agës, por s`harroheshin as këngët e nizamëve që të thernin shpirtin, sidomos këngën e Arif Sinanit dhe sinanëve të tjerë që vitet i kalonin në dhe të huaj me mallin i cili ju rëndonte sa bjeshka për dheun e të parëve, familjen dhe gjithçka që frymonte shqip.
Çdo kohë ka artistët e vet; këngëtarë, valltarë, humoristë dhe instrumentalistë. Dallojnë vetëm rrethanat kur jetuan dhe vepruan ata. Në hulumtim të trashëgimisë sonë kulturore, mësojmë se këngët, vallet dhe lojërat e ndryshme, (qoftë nga burrat, qoftë nga gratë), nuk kanë munguar në asnjë kohë.
Stina e verës, banorët e kësaj treve i shpërndante fushave për sigurimin e kafshatës së bukës së kallamojt, por kur bëhej ndonjë dasmë, gëzoheshin siç thuhej edhe trarët e shtëpisë. Në dasmë

merrnin pjesë i madh e i vogël ku edhe këndonin këngë e vallëzonin vallet më të bukura. Gëzoheshin burrat, gëzoheshin gratë e kënaqeshin fëmijët. Defatoret thurnin këngët më të bukura për nusen e cila do ta zbukuronte dhe shtonte shtëpinë, ndërsa burrat djersitnin daullegjinë me vallet e tyre.

Kujtesa popullore e trevës sonë, mban mend këngëtarë e valltarë të dalluar të cilët artin e talentin e tyre nuk kishin ku ta shprehnin, pos në dasma, oda dhe gazmende familjare. Por, kur bora mbulonte shtigjet, atëherë netët e gjata të dimrit i kalonin në këngë, lojra e humore me thumba ku siç thuhet „shkyheshin " brinjët nga të qeshurat dhe në këtë mënyrë sfidonin të keqen që pushtuesi e mbjellte kudo.

Remzi Tefik Dernjani (1944) nga fshati Paldenicë ka trashëguar nga babai i tij Tefiku (1909-1984), si vlerë të trashëgimisë shpirtërore, këto vargje therëse të lojës së Filgjanave:

Ne i falim, nuk i falim,
Çeljav derën marrshin malin!
Po thotë mali nuk i du,
Thotë Halili bimni mu!

Duke u thelluar në të kaluarën e largët, në fshatin Seçishtë dalloheshin: Hisni Luri, Kadri Luri, Mexhit Shkreta, Mendu Kuka, Hamdi Shkreta, Xhemal Shkreta, Qamil Kalisi, Afet Kalisi, Adem Shkreta, Muharrem Shkreta e Nuhi Greçani[23], të cilët me këngët, vallet dhe me tingujt e bukur të kavajve, argëtonin bashkëvendasët e tyre. Në fshatin Kryenik dalloheshin: Neshat Qajani, Azem Thaçi, Sulejman Thaçi e Sefer Thaçi[24]. Në fshatin Dimcë[25] Hamit Suma, Shahin Tuçi e Fari Tuçi, në rënie të kavajve, ndërsa Imer Tuçi, valltar. Në fshatin Guranë, shquheshin Shaqir Kaloshi, Sali Berisha, Hetem Berisha, Shefki Vila e Osman

[23] Informatë nga Rexhep Shkreta e Xhevat Shkreta si dhe Elham Kalisi dhënë autorit më 19.12.2013 dhe me 20.12.2013
[24] Informatë nga Fejzullah Krasniqi dhënë autorit më 20.12.2013
[25] Informatë nga Sahit Shiti dhënë autorit më 6.1.2014

Kaloshi [26] .Në fshatin Paldenicë shquhej Hebib Dernjani me këngën e Shaban Bushit, Tefik Dernjani me këngë majekrahu, në lodra kërcenin Abedin Vila e Faik Dernjani[27], ndërsa kur vinte për muhabet te bija e tij në fshatin Paldenicë, Bajram Tanusha[28], mblidhej i tërë katundi dhe kujtesa popullore mban mend vetëm pak vargje të një kënge të moçme të bajraqeve në hapësirën shqiptare:

Bajraqet po hiqen
Si kandil po digjem...[29]

Kujtohen edhe pak vargje të një kënge tjetër mbi njëqind vjeçare, pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ku shqiptarët të detyruar për të shkuar nizam në dhena të huaja, larg shtëpisë, gruas e fëmijëve, i këndonin gjendjes së re të krijuar, dhe kënga thotë:

Lumetna për mretin[30] tonë
Se asker nuk po na qon...

Gjithashtu, krahas artdashësve të tjera, në fshatin Puset e Nikës, shquheshin me këngë: Nazmi, Hasip e Rufat Brava, në rënie të kavajve: Qerim Brava e Selim Brava; në valle, Sim Daci, Adem Daci e Zemri Daci[31], kurse Ahmet Brava, si pjesëmarrës i LDB-së në Shqipëri, nga fshatrat e asaj ane të atdheut, kishte sjellë një buçetë këngësh në Puset e Nikës, të cilat me ëndje i këndonte jo vetëm ai, por edhe bashkëfshatarët e tij të cilët mbanin ison.

Në fshatin Dërmjak, kujtohen si artdashës Mustafë Curri në rënie të kavajve, Nevzat Curri edhe të kavajve edhe të valleve si dhe Bajrush Curri në rënie të fyellit[32].

---

[26] Informatë nga Sherif Berisha, Miqail Vila e Faruk Berisha dhënë autorit më 8.1.2014

[27] Informatë nga Sefer Çupi, dhënë autorit më 10.1.2014, Paldenicë

[28] Bajram Hyseni nga Tanusha, përndryshe gjyshi i autorit të këtij libri, pjesëmarrës i luftës në Grykë të Kaçanikut në vitin 1910 me Idriz Seferin dhe në Karadak të Shkupit në vitin 1944.

[29] Informatë nga Sefer Çupi, Paldenicë, 22.12.2013

[30] Ismail Qemali

[31] Informatë nga Nuri Brava, Puset e Nikës dhënë autorit më 13 .1.2014

[32] Informatë nga Selman Curri, dhënë autorit më 23.12.2013, Hani i Elezit

Në fshatin Rezhancë, ka kënduar Halil Rogaçi, ish i burgosur politik nga viti 1948, ndërsa kavajve u kanë rënë vëllezërit e tij, Bexheti dhe Beqiri[33].

Krahas këngëve, lojrave dhe skeçeve të ndryshme popullore ku tentohej të kënaqej shpirti i shqiptarit, tregimtari popullor nga fshati Paldenicë, Tefik Dernjani, i cili ka vdekur në vitin 1984, nëpër oda të burrave recitonte vargje të ngjarje të dhembshme mbi historinë e popullit shqiptar, përkatësisht mbi shpërnguljen e shqiptarëve për Anadoll. Këto vargje ishin realitet i hidhur dhe dëshmi e katrahurave të kohës. Për fat të mirë, këto vargje janë të ruajtura në kujtesën e djalit të tij Remziut[34] i lindur në vitin 1944 dhe kanë këtë përmbajtje:

Shita tokë e shita shpi
Shita dhen e shita dhi
U qova e dola nat t`shkretë Turki.
Në t`shkretën Turki kur jam dal
M` vdiq nana me gjeth nji djalë
Kush n`xhenaze s`pat mem ardhë.
Unë kujtoj se rrnoj n` Stamoll
E mqoj Zoti n`Anadoll.
N`Andoll kur jam shku
Me ni tokë jam hi qifqi
Po punoj me rob e thmi
Na miti zhegi more vllazni
S`kemi kun kriet ku me shti.
Shpesh po mledhmi po e bajmë dert
Haj medet se çka na gjet
Unë për veti nuk jam siklet
Po shumë shokë janë n`gazep.
Na ka rrok ni malari[35]
Tanë ne shtrat jemi shtri

[33] Informatë nga Shaban Rogaqi, dhënë autorit më 29.12.2013, Hani i Elezit
[34] Burimi: Remzi Tefik Dernjani më 2.9.2016, Paldenicë
[35] Sëmundja e malarjes

Ilaq nuk gjinet n`ket nahi.
Shpesh po mblidhmi po e bajmë dert
Haj me det çka na gjet.
Ni ujë largë na ka qillue
Gruja plakë s`munet me shkue
Djali i vogël tutet me shkue.
Na ka rrok ni malari
Tanve n` shtrat na ka shtri
Ilaq nuk gjinet n`ket nahi…

Krahas këtyre vargjeve tragjike nëpërmjet të cilave shprehej plaga e katandisjes së shqiptarëve në Anadoll, plaku Tefik Dernjani thumbonte edhe sjelljet dhe doket e kohës kur jetonte ai:

Due me fol për kohën e sodit
Qe nuk jemi në izë të Zotit
Për nga ana e Perenisë
Prej vllaznive jemi braktisë
Jemi te que kohën me kangë e me loja
Në sahat dekës do t`na merret goja;
Hej moj gra he gur e rrasa
Hiq s`po kujtohi veq nëpër darsma
Kur t`vjen dini i namazit
Lipe ndimën prej elmazit
Burri i shkret nau ba llom
Pesëmijë banka ni kat najllon
Di-tri her gruja i vesh
-Mor burr zeza jam met deshë!

Ndër dhjetëra punime të tjera, në muzeun shpirtëror të veteranit të muzikës shqipe Sejdi Dernjani, shquhet Okarina ilire e gdhendur në vitin 2012

Kënga e Shaban Bushit dhe historiku i saj

Kujtesa popullore nëpër furtunat e kohës, ka ruajtur një këngë të moçme, mbi 100 vjeçe e cila u lind, u këndua dhe është ruajtur në odat e fshatit Paldenicë.[36]

Kjo këngë, në brendësi të materies që shtjellon, përmban një ngjarje me rëndësi historike dhe si e tillë është reale dhe ka protagonist mbase shumë të veçantë.

„Kâjka e Shaban Bushit'' [37] u shkrua dhe është kënduar për dekada me radhë nga Hebib Ferat Dernjani nga fshati Paldenicë. Mixha Hebib, siç e quajnë edhe sot me respekt mbamendësit e tij, ishte i lindur në vitin 1889[38] dhe ka vdekur në vitin 1962.[39] Ky njeri i urtë dhe i pa sherr, si e kanë karakterizuar bashkëkohësit e tij, me „gjuhën'' e mendjes ka thurë një visare të çmuar të historisë dhe trashëgimisë sonë shpirtërore.

[36] Pjesën dërmuese të tekstit të kësaj kënge e kam marrë nga Rasim Dernjani (tani i nderë) në vitin 2006 , ndërsa në vitin 2016 nga Qerim Dernjani e Sefer Dernjani, të gjithë nga fshati Paldenicë

[37] Shaban Bushi ishte nga Bushët e Poshtëm të Puseve të Nikës

[38] Burimi: Basri Meliqi, zyrtar i Ofiqarisë në Han të Elezit

[39] Informatë nga Ibush Dernjani

Ngjarja ka ndodhur në kohën e pushtimit turk, përballë çaushit mizor Muharrem Zhuta dhe zaptive të tij. Në këtë luftë të pabarabartë, vritet Shaban Bushi nga Bushët e Poshtëm të Puseve të Nikës.[40] Në kontekst historik e kemi të vështirë të saktësojmë se në cilin vit me saktësi ndodhi kjo ngjarje, andaj për të sheshuar në detaje atë, duhet kërkuar fakte të reja arkivore, sidomos nga arkiva turke. Sipas rrëfimit të Shefket Bushit[41] kjo ngjarje ka ndodhur në kohën kur ka lindur Osman Bushi, babai i Zejadin Bushit. Vrasja e Shaban Bushit te,, Ara e Isuf Çupit''[42] në fshatin Paldenicë, jo vetëm që involvon në luftë pothuajse tërë familjen e Sadikëve: Shabanin, Ismalin dhe nipin Mehmetin[43] ku Shaban Bushi kishte qenë për të gri duhanin, por në luftë kundër hordhive të Muharrem Zhutës ngriten edhe fshatrat për rreth si Dërmjaku e Gjergjedelli. Kjo luftë zhvillohet brenda një dite dhe fillon nga vendi i quajtur ,,Brija" të fshatit Paldenicë dhe tërë Prroit të Kolorashës duke përfunduar te Mullini i Ukish Çupit[44], aty ku sot është restorant,,Alba".

[40] Sipas burimeve të Shefket Bushit dhe Abedin Bushit, Muharrem Zhuta, vret edhe vëllaun tjetër të Shaban Bushit, Mustafën në Fushë të Shkupit derisa ky i fundit kishte zënë pusi që të vret çaushin Muharrem Zhutën. Muharrem Zhuta, duke ditur që familja e Shaban Bushit do të hakmerret, Zhuta në kalin e tij (si truk) kishte hipur një zapti të cilin e vret Mustafë Bushi, ndërsa vet ai qëndron në fund të kolonës në kalin e një zaptie tjetër. Në kundërsulm vritet Mustafa i cili vëlla kishte Shabanin dhe Avdullahun.

[41] Nga burimet e librit të amzës së të lindurve, nga zyrtari Basri Meliqi mësojmë se Osman Bushi ka lindur në vitin 1890 ndërsa ka vdekur në vitin 1962. Është i biri i Avdullahut dhe i nënës Shahe.

[42] Sipas informatës së Sefer Dernjanit marrë nga babai i tij Ademi

[43] Informatë nga Sejdi Dernjani dhënë autorit më 2.9.2016. Nga kujtimet e hallës së Sejdiut, Nexhmijes e lindur në vitin 1899, thuhet se kjo ngjarje ka ndodhur më vonë dhe si pasojë Mehmeti dënohet me 4 vite e gjysmë burg, të cilin ai e vuan në Kala të Shkupit, ndërsa Shaban Dernjani ikë në Gjakovë dhe nuk kthehet në Paldenicë për 4 vite e gjysmë. Në fakt Mehmeti u dënua me 25 vite burg, por meqë familja, shiti tokën dhe i dha 25 lira turke, ai mbajti vetëm 4 vite e gjysmë.

[44] Informatë nga Shefket Bushi (1945) dhënë autorit më 3.9.2016. Në fakt Mullini i Ukish Çupit është shkatërruar kur u ndërtua hekurudha në vitin 1873-

Kjo ngjarje, natyrisht se kishte lënë gjurmë të thella në kujtesën e banorëve të fshatit Paldenicë, andaj autori i kësaj kënge Hebib Ferat Dernjani, kështu na e solli për historinë:

Krisi pushka rreth ni dushki[45]
Po lufton aj Shaban Bushi;
Shaban Bushi ku je kanë
N`Paldenicë, nër Derjan.
Te Sadikt unë jam kanë
Kesh me gri ni okë duhan
Pritën Zhuta ja kish zanë
Qat martinën me naj dhanë.
Nuk muj pushkën me ta dhanë
Menjëher ka kci n`llagam;
Kcej n`llagam mas ni guri[46]
Kerset pushka e Shaban Bushit.
Krisi pushka tuj liftue
Ket Shabanin e kan rrethue
Keq Shabanin e kanë varrue.
Thrret Shabani, Shaban[47] o vlla
Ismalin[48] a ma ke pa
Ismalin ku ma ke que
N`Gjergjedell aj ka qëllue
Unë haberin ja kam que
Për pesë dakika kam me ta prue.
Vjen Ismali hem Xhemali[49]

---

74. Vite më vonë, në afërsi të mullirit të Ukish Çupit, është ndërtuar Mulliri i Veli Vilës, andaj rrethimi i zaptive është bërë në fund të ditës në këtë mulli. (sqarim i autorit Sh.Çupi)

[45] Dy vargjet e para janë marrë nga Qerim Dernjani, më 2.9.2016, të cilat ai i ka mbajur në mend nga babai i tij Tefik Dernjani (1909-1984). Vargjet tjera janë marrë nga Rasim Dernjani.

[46] Sipas Sefer Dernjanit, gurët e Arës së Isuf Çupit

[47] Shaban Bushi thërret Shaban Dernjanin

[48] Vëllau i Shaban Dernjanit

Vjen me ta hem Muharremi[50]
Xhemal Curri[51] holl po qet
Ja vranë kalin Zhutës s`shkretë.
Dy zapti plagu janë kanë
Bashkë me to, Zhuta ran.
Ikin prronit tuj gjimue
Kolorashën e kanë trupue
Na ikë Zhuta me zapti
Don me pshtue ne mulli.
Kadal Zhutë musteqezi
Tash po sheh trima me sy
Kadal Zhutë musteqe troftë
Po shkon jazit sikur shotë
Sikur shota asht mshel n`mulli
Me krejt çka ka pas zapti.
Ramë Ramuka[52] ish kanë n`mulli
Tuj blu drith aj për shpi tij
Ramë Ramuka ban medet
Ku-ku kalin çka ma gjet.
Atëher Zhuta, Ramën e ka shtrëngue[53]
Shpejt haberin n`Kaçanik me que
Thuj Zhutën e kanë rrethue
E kanë rrethu e kanë mshel n`mulli
Se lshojnë t`gjallë as me zapti.

---

[49] Xhemal Curri nga Dërmjaku

[50] Muharrem Elezi nga fshati Gjergjedell dhe sipas kujtimeve të Selam Dernjanit (1920-2001) dhënë autorit në vitin 1997, në këtë luftë mori pjesë edhe Ismal Elezi.

[51] Nga libri i amzës, nga zyrtari Sabri Dernjani, mësojmë se: Xhemal Curri është i lindur në vitin 1870, ndërsa vritet ng serbët në vitin 1912, në masakrën serbe të fshatit Dërmjak. Ishte babai i Agush Currit.

[52] Ramadan Ramuka

[53]Shtrëngue(kërcnue)

Autori i librit në vendin e quajtur,, Ara e Isuf Çupit'' në vendin ku mendohet se është vrarë Shaban Bushi në luftë me zaptitë turke

Violinat dhe disa nga instrumentet frymore, të punuara me një përkushtim të veçantë nga Sejdi Dernjani, veteran i SHKA„Sharri'' në Han të Elezit

Mikëpritja në trevën e Hanit të Elezit

Treva e Hanit të Elezit shtrihet në jug të Republikës së Kosovës dhe ka një sipërfaqe prej 83 km² dhe me rreth 10 mijë banorë. Vendbanimet e saj shtrihen ndërmjet maleve të Sharrit dhe ato të Karadakut të Shkupit. Është një zonë etnografike me pasuri të shumta materiale e shpirtërore dhe krahas pozitës së mirë gjeografike ku gërshetohen dy klima, ka edhe pasuri nëntokësore e mbitokësore, por mbi të gjitha shquhet me një kulturë të lashtë të mikpritjes.

Ashtu si në të gjitha trevat shqiptare, edhe treva e Hanit të Elezit shquhet me mikpritjen si një traditë e vjetër iliro-shqiptare dhe shtëpia, para se të jetë e pronarit, është e Zotit dhe mysafirit. Në rrjedhë të këtij zakoni, mysafiri në trevën e Hanit të Elezit është pritë e mirëpritë si është më së miri. Fillimisht, mysafiri mirëpritej me një buzëqeshje që në dyert e hyrjes në oborr, duke lënë të kuptohet se ai është shumë i mirëseardhur në konak. Posa futej brenda, i Zoti i shtëpisë kërkonte nga mysafiri që të „rahatohet''

që donë të thotë të mos ketë kurrfarë kompleksi dhe në vazhdim gostitej me kafe. Në trevën tonë, kur kafeja që pimë sot ka qenë më pak e njohur, i është ofruar kafeja nga elbi dhe pas kafesë, mysafirit i është ofruar buka, pavarësisht se a ishte i uritur apo jo. Udhëtari dhe mysafiri nuk pyetet për bukë, thonë më të vjetrit tanë, atij duhet t`i shtrohet ajo. Zakonisht, buka shoqërohej me gjizë, djathë, speca e domate dhe kjo ishte vetëm sa për të ,,prishur'' urinë. Varësisht prej kohës kur ka ardhur mysafiri, për darkë i është ofruar pasul i zier në veksh, por nëse ka ardhur më herët, për te janë gatuar edhe petë (laknor) ose kollpite, krelanë...flija.

Mysafiri në trevën e Hanit të Elezit, tregojnë më të vjetrit, kur ka pasur kohë, ka ndejtur edhe një apo dy ditë tjera, por ka pasur raste kur është ftuar edhe nga fqinjët e zotit të shtëpisë dhe krejt kjo bëhej për ta nderuar mikun, mysafirin.

Zakonisht, në trevën e Hanit të Elezit, kur vinte ndonjë mysafir, mblidhej i tërë katundi dhe mysafiri nderohej me ,,muhabet'' e lojëra të ndryshme sidomos ajo e filxhanëve, e kapuçave e cila shoqërohej edhe me këngë pak a shumë ngacmuese për palën e cila kishte humbur lojën, por rrallë ose kurr nuk kemi dëgjuar se miqët janë prekur apo hidhëruar rëndë; përkundrazi kanë ngjallë atmosferën dhe janë shndërruar në gazmor.

Mysafiri, në konakun e zotit të shtëpisë konsiderohej i shenjtë, nderohej e respektohej dhe kjo traditë vazhdon edhe sot. Është e vërtetë që kanë ndryshuar kushtet e mikpritjes, por jo edhe përmbajtja, si një traditë e vjetër shqiptare dhe kjo është normuar edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit.

Kur shkonte mysafiri, ai përcillej deri në dalje të katundit dhe kishte raste kur mysafirit, në shenjë respekti i jepeshin një palë çorapë.

Nëse mysafiri ka ardhur me kalë, një nder i bëhej edhe kalit të tij të cilin e ushqente i zoti i shtëpisë sepse konsiderohej fyerje për mikun, nëse nuk i shërbehej edhe kalit.

Tradita e pritjes dhe mikpritjes së mysafirit në trevën e Hanit të Elezit është pothuajse e njëjtë me të gjitha trevat shqiptare, por

dallon nga numri jo i madh i odave të veçanta të pritjes të cilët i kanë kushtëzuar kushtet ekonomike. Pritja e mikpritja bëhëj brenda shtëpisë ku me bukë, kripë e zemër nderohej mysafiri.
Në tërë historinë e mbamendjes shqiptare në këtë trevë, nuk mbahet mend që miku të jetë prerë në besë apo fyer e poshtruar në konakun e mikëpritësit dhe po të ndodhte një gjë e tillë ateherë besëpreri „leqitej'' dhe dëbohej nga katundi.
Tradita e mikpritjes si një vlerë e trashëgimisë sonë, si një zakon i mirë popullor, vazhdon të ruhet edhe sot. Duke u bazuar në kushtet e mira ekonomike, shumë kryefamiljarë kanë ndërtuar oda të veçanta, të quajtura konaqe dhe mirëpresin mysafirë ku ftohen edhe rapsodët e kësaj ane dhe vendbanimi më i njohur për këtë lloj pritje janë Puset e Nikës.
Është me interes të cekim se nëse ndonjë mysafir apo delegacion i rastit vjen në komunën e Hanit të Elezit, mysafirët jo vetëm që mirëpriten nga kryetari i komunës, por kur shkojnë, përcillen nga i zoti i komunës deri në dalje të objektit komunal që donë të thotë se tradita e mikpritjes, jo vetëm që është normë në shtëpitë e kësaj treve, por ajo është prezente edhe në institucione.

Fejesa në trevën e Hanit të Elezit

Bashkimi i dy të rinjëve, gjithmonë ka pasur një rëndësi të veçantë dhe është përcjellë me doke e zakone të ndryshme dhe ceremonia paraprirëse e martesës ose dasmës ka qenë fejesa.[54] Në trevën e Hani të Elezit ka pasur disa lloje të fejesave si: fejesa në bark të nënës, fejesa në djep, fejesa me shkuesi. [55]
Fejesa në bark të nënës dhe fejesa në djep në trevën e Hanit të Elezit kanë qenë të rralla, ndërsa fejesa me shkuesi ose me msitni ka qenë me e përhapur në këtë trevë dhe ka qenë e pranishme

[54] Elvana N. Bushi „Fejesa me shkuesi në trevën e Hanit të Elezit'' punim seminarik, Departamenti i Antropologjisë –Programi Arkeologji, Prishtinë
[55] Po aty

pothuajse deri në fund të shekullit XX. Fillimi i kësaj ceremonie ka nisur kur babai i djalit ka gjetur një person i cili ishte i afërt me familjen përkatëse të vajzës. Më së shpeshti në trevën e Hanit të Elezit si msit i vajzës është caktuar ose daja ose mixha i sajë.[56] Kur msiti është nisur në rrugë për të shkuar tek shtëpia e vajzës, ishte adet që njërën nga lidhëset e këpucës së tij ta linte të zgjidhur, ndërsa kur është kthyer ka lënë lidhësen tjetër. Kjo është bërë me qëllim që të bëhen *dinazi* , pra të kenë fatin e mirë, që të bashkohet çifti i ri.[57]

Pas futjes së msitit brenda, fillonin të bisedonin për arsyen e ardhjes dhe të pranishëm kanë qenë vetëm burrat. Edhe nëse ka ndodhur që me herën e parë kërkesa e msitit t`i ketë pëlqyer të zotit të shtëpisë, ky i fundit nuk ia ka dhënë ,,dorën'' menjëherë, për të mos lënë përshtypjen se ,,mezi paska pritur'', por e ka endur msitin dy e tri herë. Gjatë bisedimeve msiti ka bërë shumë lëvdata për shtëpinë e djalit dhe shpeshherë kan qenë të zmadhuara, ndërsa interesimi i babait apo zotit të shtëpisë më së shumti ka qenë për djalin, pastaj për gjendjen ekonomike, për moralitetin e familjes dhe gjithsesi kanë kërkuar të dinë mos janë në gjak ose fis ndërmjet veti[58]. Me marrjen e vendimit që të bashkohen dy të rinjët, babai i vajzës, msitit i jep ,,dorën'' dhe një ,,shenjë'' zakonisht një shami e qëndisur me karajfila. Msiti pas marrjes së ,,shenjës'' i kënaqur se e msitnoi edhe një vajzë, plotë gëzim niset në drejtim të shtëpisë së dhëndërrit ku edhe merrte shpërblimin për angazhimin e tij. Msiti me të hyrë në oborrin e shtëpisë së dhëndërrit të ri, pritej me këngë si:

Na ka ardhë ni dorë:
Na ka ardhë ni fjalë,

[56]Po aty
[57] Po aty
[58] Elvana N. Bushi ,,Fejesa me shkuesi në trevën e Hanit të Elezit'' punim seminarik, Departamenti i Antropologjisë –Programi Arkeologji, Prishtinë

Na ka ardhë kollaj,
Si me k`put ni dardhë...
Gëzimi nga fejesa shoqërohej edhe me të shkrehura pushke, kështuqë i tërë katundi kuptonte për fejesën e bashkëfshatarit të tyre dhe pasonin uratat për të zotin e shtëpisë. Më pas fillonin përgatitjet për myzhden e fejesës dhe nga ana e vajzës në myzhde shkonin daja, mixha, ndonjë kusheri dhe vëllau i nuses. Msiti ishte në krye të vendit dhe ishte adet që në prani të dy familjeve dhe mysafirëve të tjerë të dorëzohej "dora e nuses''. Pasi ngriteshin në këmbë të gjithë të pranishmit në dhomë, msiti dhe babai i djalit bënin ,,dorëzimin e dorës'':
- A ja ke lyp filanit(përmendej emri i babait të vajzës), çikën për djalë?
- Po.
- A ja ke lyp filanit çikën për djalë?
- Po.
- A ja ka lyp filanit çikën për djalë?
- Po.
- Zoti ta ka dhanë, edhe ai(babai i çikës) ta ka dhanë çikën për djalë dhe kështu zyrtarizohej fejesa.
Ishte adet që vajza e sapofejuar, nga turpi që ishte fejuar, për tri javë me radhë të mos kontaktonte anëtarët e familjes, sidomos burrat, ndërsa për t`u takuar me të sapofejuarin as që bëhej fjalë. Ate mund ta shihte vetëm kur të martohej, pra natën e parë të martesës. Pas kryerjes së këtyre adeteve e formaliteteve, nga dy familjet fillonin përgatitjet e tjera për martesë.
Vajza, me ndihmën e nënës, që në moshë të re fillonte ta mbushë fundin e arkës së sajë me çejz(pajë), por pas fejesës, ajo tanimë punonte më me ngulm, pasiqë prindërit ia kanë përcaktuar fatin jetësor. Paja e sajë, një ditë do të vlerësohet nga të tjerët, andaj ajo thurej mirë, zbukurohej me motive të ndryshme. Shumica e motiveve, që janë elemente zbukurimi të pjesëve të veshjes apo shtrojës, janë motive popullore të trashëguara që shpeshherë heqin gjurmët që nga koha e besimit parakristian dhe që janë përcjellë nga një gjeneratë në tjetrën. Disa elemente të veshjes ose pajës

janë të stolisura me motive në formë të rrathëve koncentrik, që mund të konsiderohen gjurmë të motiveve solare si elemente autoktone ilire, kryqi i thyer i modifikuar si simbol solar, vijat lakore gjarpërore si mbeturina të kultit të gjarprit të cilat simbolizonin pjellorinë e tokës dhe të gruas.[59]
Ngjyrat më të shpeshta që hasen në pajën e nuses janë e bardha, e zeza, e verdha, e kaltërta si dhe e kuqja me të zezën.[60]

Pajë nuserie e vitit 1950, Paldenicë

Në trevën e Hanit të Elezit, të kushtëzuar nga gjendja e vështirë ekonomike, shumica e familjeve kanë pranuar atë që miku ka pasur mundësi t`i dërgoj, por ka pasur raste kur dhe miku është detyruar të blej atë që baba i vajzës e ka kërkuar. Edhepse këto kanë qenë raste të rralla, megjithate kanë qenë prezente në trevën tonë. Zakonisht te nusja është dërguar patiskë, një lloj materiali që është përdorur për mbulesa dhe këmisha dhe dy thas lesh t'dhenve që është përdorur për çorapa, jelek e gjithçka të

[59] Myzafere Mustafa „ Përgatitja e pajës dhe disa elemente rituale përcjellëse të saj'', botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës në kuadër të përmbledhjes „Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore'' Prishtinë 1983, fq.163
[60] Po aty fq.163

nevojshme. Po ashtu vajza duhej që t`i siguronte dy parë opinga për veten e saj dhe dy parë opinga për burrin. Vajza thurte punime nga më të ndryshmet (bakshishe) për të gjithë anëtarët e shtëpisë së burrit, që kur ajo të shkoj nuse t'ia dërgoj në formë dhuratash. Ajo përkujdesej që të siguroj dhuratë edhe për kalin që ajo do të qëndroj mbi atë kur të shkoj nuse. Punonte tufa me pasqyrë për t`ia vënë kalit në ballë, rruza të shumta e të llojllojshme dhe gjithsesi dhurata thurte edhe për daullegjinjët dhe defatoret që e këndonin, por nuk harronte të qëndiste edhe shtrojën e djepit për fëmijën që do ta lindë.[61] Ndërsa për gjërat që është dashur t`i blejnë në treg, nga nusja është marrë ,,masa'' për të ditur gjatësinë e saj sepse nuk lejohej që vajza pa u martuar të takoj anëtarët e familjes së burrit. Në shumicën e rasteve ,,vadja''[62] është ndarë ose pas ditës së Shëngjergjit ose para ditës së Shmitrit, por kishte raste kur miqësia shkonte me ,,huje'' dasma caktohej edhe në mes të dimrit. Me ndarjen e vades, përfundonte ceremonia e fejesës dhe fillonte përgatitja e dasmës për martesë.

[61] Myzafere Mustafa ,, Përgatitja e pajës dhe disa elemente rituale përcjellëse të saj'', botuar nga Instituti Albanologjik i Prishtinës në kuadër të përmbledhjes ,,Trashëgimia dhe transformimi i kulturës popullore'' Prishtinë 1983

[62] Dita e martesës

Pajë nuseria e viteve 1950

Dasmat në trevën e Hanit të Elezit

Martesa është një nga ngjarjet më të rëndësishme të jetës së njeriut. Ajo është baza e krijimit të familjes[63] dhe realizohet nëpërmjet gëzimit familjar që quhet dasëm.

Dasma është ngjarje kulminante e cila i bashkon dy të rinj, dhëndërrin e nusen. Ajo është e kremtja më e rëndësishme në tërësinë e zakoneve familjare. Me të realizohet marrëveshja e filluar me fejesë.[64]

Dasma, përkatësisht martesa ishte një institucion i rëndësishëm familjar dhe mund të vështrohet nga shumë aspekte, e veçmas nga

[63] Abaz Dojaka „Etnografia shqiptare 11'' Tiranë 1981, fq. 3

[64] Dr. Valbona Begolli„ Pozita e gruas në Kosovë me një vështrim të posaçëm në të drejtën zakonore'' Prishtinë 1984 fq.60

prizmi etnografik, sociologjik dhe poetik.[65] Sipas të drejtës zakonore, të martohesh do të thotë të krijosh familje, të shtosh fuqinë punëtore në familje dhe të lindësh fëmijë.[66]
Në trevën e Hanit të Elezit, në të kaluarën, dasmat bëheshin ditën e enjëte dhe vazhdonin për tre ditë me radhë. Në dasëm, përpos miqëve e farefisit, grishej edhe i tërë katundi.
Dasma fillonte që në çastin kur i zoti i sajë, në lamën e shtëpisë shtronte mutafin mbi të cilin zbraste një teneqe grurë dhe mbi grurë vendoste një tufë lule basulegu. Pas këtij rituali, vinin katundarët për t`ia uruar dasmën të zotit të shpisë dhe me vete merrnin nga një tepsi me grurë të cilën e stolisnin me lule dhe ,,sheqera të larëm''dhe e zbraznin mbi mutaf.
Kjo ndihmë bëhej sepse tokat ishin jopjellore e rrjedhimisht familjet e kishin problem që të siguronin bukën për një vit. Grurin e dhuruar, pastaj e bluanin në mulli dhe kështu sigurohej
buka për dasmorët.
As mos u lidh Lulie, as mos u përdridh,
A t`kanë kallxue Lulie se do t`qesin drith?
Mue m`kanë kallxue, qysh ditën e hanë,
M`u këputen kam` e dor` e mbeta në lamë[67].
Pas kësaj ndihme, katundarët sjellnin edhe nga një kalë dru për zierjen e ,,jemekeve''. Krahas kësaj, caktohej edhe shtëpia ku do të mblidheshin krushqit si dhe ,,hyzmeqarët'' që do të shërbenin nëpër oda. Me kohë caktoheshin magjetoret për gatimin e bukës si dhe kuzhinieri që ziente gjellën e havllën, i cili quhej ,,jakqi''.
Derisa nga ana e dhëndërrit fillonte dasma, nga ana e nuses fillonte kanagjegji, një ritual i veçantë e domethënës i cili njihej ndryshe si ,,ngjitja e kanës'' e cila fillonte me këngën mallëngjyese:

[65] Mr. Hajdar Loku ,,Këngë dasme nga rrethina e Kaçanikut'',Prishtinë 2004 fq. 5
[66] Dr. Valbona Begolli,, Pozita e gruas në Kosovë me një vështrim të posaçëm në të drejtën zakonore'' Prishtinë 1984 fq.60
[67] Po aty fq. 8

Ngjesim kanën pika pika,
ty t`ka nana bajrak nër çika.
Si dhe:
Ani, kaj oj çikë, kaj e mos mej;
Ani, kaj me lot, e mos na rrej...
Për të vazhduar më tej:
Oj Lulie shumë e mirë
Thuju shoqeve lamtumirë![68]
Dasma bëhej zakonisht me lodra e zurle, por edhe me këngëtarë. Gjatë tërë natës vallëzonin, këndonin e luanin lojra të ndryshme. Të nesërmen, pasi dasmorët të hanin mëngjesin, caktoheshin inxhet apo gratë e kerrit, djali dhe vajza e kerrit, bajraktari i cili ishte në krye të kolonës së krushqëve si dhe ,,çaushi'' që mbante rendin dhe disiplinën e dasmorëve.
Kur krushqit arrinin te ,,zjarri''(vendi ku priteshin krushqit) i mirëpriste babai i nuses me bashkëfshatarët e tij të rreshtuar në anën e djathtë. Zakonisht pritja bëhej në hyrje të katundit, në livadh. Ishte rregull që kryefamiljari të mos i vonoj krushqit rrugës, por të vjen në kohën e caktuar, ashtu siç janë marrë vesh ditën kur janë dorëzuar ,,petkat''[69] si dhe të mos shkrepte as pushkë e allti pa u bërë ,,teslimi''i nuses. Në të kundërtën, kjo cilësohej si fyerje dhe pasonte dënimi me të holla.
Derisa pritej marrja e nuses, ajo nga inxhet e kerrit këndohej:
Mori nuse, nusja jonë,
Na i qit arkat t`i ngarkojmë,
Qit qilimat na t`i mlojmë,
Qiti janat t`i heshojmë[70].

[68] Mr.Hajdar Loku ,, Këngë dasme nga rrethina e Kaçanikut'' Prishtinë 2004, fq 10
[69] Kur nusja merrej ditën e dielë, petkat(teshat, çeizi,paja) dorëzoheshin ditën e enjëte. Atë ditë detajoheshin të gjitha gjërat rreth përcjellëshit.Të njëjtën ditë, çeizi ,,shtrihej''nëpër oda dhe vinin gratë e katundit për ta parë dhe kështu vlerësonin punin e vajzës.
[70] Këngë dasme e marrur nga Rabije Loku, nëna e dëshmorit Gafurr Loku

Te Zjarri, zakonisht, krushqit nuk duhet vonuar shumë. Të fundit që ndahen në mes të dy palëve janë babai i nuses dhe babai i dhëndërrit dhe në prani edhe të familjarëve të tjerë bëhej „teslimi'' i nuses: „Robi i yt, gjaku i im"-thoshte babai i nuses dhe kështu bëhej pranim-dorëzimi. Ky relikt i „teslimit'' (me përjashtime) është ende prezent në trevën e Hanit të Elezit.
Në trevën e Hanit të Elezit, nusja krahas qejzit të saj, në familjen e burrit duhej të sillte dy jana, dy qilima, këmisha dhe rrobe të tjera të brendëshme të punuara në vek si dhe dhurata për familjen dhe farefisin e burrit.

Motiv nga marrja e nuses[71]

Nusja merrej me qerre mbi të cilën vendoseshin thupra harkore e mbi thupra vendoseshin qilimat. Në pjesën e përparme dhe të pasme të qerres vendoseshin dy çarçaf. Kur nusja merrej me kalë(në trevën e Hanit të Elezit deri kah viti 1975) mbi trupin e nuses vendosej një thes i gjatë i cili mbulonte tërë trupin e sajë, kurse mbi kokë të nuses vendosej plisi i bardhë i rrethuar me një kurdele të kuqe.
Si element apotropeik, ishte një adet i kahershëm, që kur krushqit ktheheshin pas marrjes së nuses, duhej „thyer rruga'' që të thyheshin të këqijat e çiftit që po martoheshin dhe kjo traditë

[71] Marrë nga interneti

përdoret edhe sot. Në fakt, mbrojtja nga të këqijat, fillonte që pas fejesës së dy të rinjëve. Në trevën e Hanit të Elezit, si masë apotropeike ishte : vendosja e zhivës në trup, lëkura e gjarpërit e mbështjellë në shtatë katë mushama dhe bartja e tij në trup, bartja e hajmalive të ndryshme dhe ishte zakon që në natën e martesës, njëri nga çifti martesor të mos flinte.

Me të arritur nusja në shtëpinë e burrit, oshtinte oborri nga këngët që këndoheshin me plot hare dhe zbrazeshin pushkë. Zbritjen e nuses nga kali apo kerri e bënte i zoti i shtëpisë duke u shoqëruar edhe me këngën:

Lëshoni udhë, lëshoni sokak,
Se po e zhdrypim një bajrak.[72]

Dhe më pastaj fillonte një ritual ilirian me veprime të ndryshme, duke filluar nga plisi i bardhë i cili i vendosej fëmijës dhe nuses në kokë, më dëshirën që nusja e re, shtëpinë ta mbushë me djem. Pastaj nusja hipur mbi kalë duhej të kalonte nëpër një zgjedhë e cila i qëndronte para këmbëve të saj e që simbolizonte harmoninë, marrëveshjen dhe respektin ndërmjet burrit e gruas. Në rrugëtimin e saj ritual, patjetër që duhej nderuar magjja e shtëpisë dhe nën sqetullat e nuses vendoseshin dy bukë. Pas nderimit të magjes dhe ,,kimetit'' të bukës, nusja drejtohej për në dhomën e saj dhe pasi prekte me duar pragun e dhomës, uronte që jeta e saj martesore të jetë e bereqetshme.

Në anën tjetër, krushqit organizonin vrapime me kuaj, vrapime të djemve të rinj e cila quhej ,, e ngarenme'', kërcim në tre hapa si dhe hedhjen e gurit, ku fituesit shpërbleheshin me ndonjë ,,marhamë''.

Me dasmën nuk gëzohej vetëm familja e farefisi, me dasmën gëzohej edhe katundi. Ajo kishte edhe vlerën argëtuese dhe ditët e dasmës i përshkuante një gëzim i madh popullor. Pos që këndohej dhëndrri e nusja, ishte traditë që të luheshin edhe lojëra të tjera si ajo e filxhanave, bletës, batit, ujqëve, e pampurit, me e ruajt

[72] Mr. Hajdar Loku,, Këngë dasme…'' fq.11

mishin, kush e ka mihirin, loja me e puth shkamin, loja cime-cjau, një trup-dy trup, loja e kapuqave, loja pare cuk, etj.

Një tufë këngësh arshikie nga fshati Guranë[73]

I
Dola n`udhë e po te pres
Ne aksham e ne mengjes
A do m`kajsh ti kur do vdes.
As të kaj e as t`vajtoj
Vorrin tan do ta maroj.
Vorrin tem kur do ta marojsh
Ditë për ditë t`vajsh e tem shllojsh
A jam kalb, a jam sosë.
Nuk jam kalb as nuk jam sosë
Kam bi lule me kullosë.

II
Oj e majr, e majr po t`thojnë
Kush ta man sahatin n`dorë
Cucë Gorance, kraje mollë
Cucë Gorance vetull hollë
Vetull hollë e qafë bardhanë
T`majr mi paske qato dhamë
Nama nja ta baj gjilpanë
Ta qenajsi me marhamë
T`ja qoj djalit për Bajram.

III
Kur dola te dera e madhe ishte nji derdimen
As teqe as te kne, rrajke me nji ven
Ore derdimen që rrajn me ni vend
Për ni cucë katuni u bane verem
U bane verem u verove
Cucën e katunit sun e more.

[73] Burimi, Hekrem Brava, Puset e Nikës

Veku

Veku në trevën e Hanit të Elezit ka pasur një përdorim të gjërë. Thënë ndryshe, veku ishte „fabrika'' e amvises shqiptare. Në vek prodhohej e tërë veshja, shtroja e mloja duke filluar nga tirqit, xhurditë, jelekët, çarçafët, pëlhurat, marhamatë, kamishat, veshjet e brendshme, janat qilimat, mësallat, skutaqet, brezat, uçkurat, duvak të nuses, rrogzina, sixhade, etj dhe çdo gjë që i duhej jetës së përditëshme. Puna në vek ishte e vështirë, andaj jo të gjitha gratë merreshin me këtë zeje. Ata që nuk dinin të vekonin, porositnin punë te vekataret, qoftë me të holla, qoftë mallë me mallë, si p.sh. jepnin lesh deleje, ndërsa merrnin rrobe për fëmijë. Në trevën e Hanit të Elezit, puna në vek është zhvilluar deri kah viti 1978 dhe si e tillë tani është shuar plotësishtë.Gjurmët e punëve në vek, ende i gjejmë nëpër shtëpitë tona, por fatkeqësisht si relikte të fundit si këmisha, breza, jana e qilima.

Meqenëse veku si mjet jetese, tanimë i takon muzeut, përkatësisht lashtësisë, ne po i paraqesim pjesët e tij:

Kambët e vekut

Dërrasa për ulje
Shuli
Nërskamset
Liqtë
Shpata
Fulqitë
Drukëza
Qeza

Krahas këtyre pjesëve, veku përshkruhet edhe me pjesë tjera të lnorjes së leshit pa të cilën veku nuk mund të punoj.Elementi bazë i punës në vek është leshi i deles. Leshi është lënda e parë e punës dhe pasi qetheshin dhentë, leshi lnorej në Shkup, ndërsa tjerrja bëhej prej vekatares. „Mlojsat'' janë mikrotoponimi më tip në fshatin Paldenicë ku janë shtrirë e përpunuar fijet e gjata të leshit të lnorur, duke formuar pastaj „cukla'' për jana etj.

Përkundër interesimit tonë, sot në trevën e Hanit të Elezit askush nuk merret me këtë artizanat, andaj konkludojmë së është i shuar.

Këmisha nusërie të punuara në vek, 70 vjet të vjetra

Punime në vek

Skutaqja, marhama, jani[74] dhe tirqit

[74] Skutaqja,marhama dhe jani janë prone e prof.Nejazi Dernjanit, ndërsa tirqit dhe pjesët tjera në fotografi janë marrë nga Muzeu Etnografik në Prishtinë

Çarçaf i thurur në vek i vitit 1936[75]

[75] Çarçaf i punuar nga Xhezide Çupi (1925-2006), Paldenicë. Ky çerçaf është prodhim veku i vitit 1936

Veku dhe pjesët e tij[76]

[76] Veku është marrë nga interneti, ndërsa pjesët e tij nga Muzeu në Ferizaj.Fotogarfitë poshtë janë nga Oda e Luzhës-Begracë

Xhamia –shkollë në Puset e Nikës

Vendbanimi i Puseve të Nikës, i përbërë prej disa lagjeve si ajo e Bravëve, Ballazhëve, Dacëve, Bushve të Poshtëm e të Epërm, tanimë e njohim si një vendbanim me vlera jo të vogla; arkitekturale, historike, etnografike e etnologjike.

Objekti i parë shoqëror që u ngrit në këtë fshat është xhamia e fshatit e cila u ngrit në vitin 1936. Fotografia na e sjellë në origjinal pamjen e xhamisë së Puseve të Nikës e cila pas Luftës së Dytë Botërore(LDB), ana e djathtë e sajë u shndërrua në shkollë shqipe. Kjo xhami-shkollë, kreu ndershmërisht dy veprimtari; ritualin fetarë dhe atë shkollor, andaj si e tillë ka vlera të dyfishta.

Mësuesit që kanë punuar në xhaminë- shkollë nga viti 1947 e deri në vitin 1957 janë[77]:

Mësues Agushi nga Gjilani, Hiseni i Ferizajt, Bajrami i Ferizajt, Ramadan Sazlia nga Ferizaj, Idrizi i anës së Prishtinës, Tasimi nga Ferizaj i cili edhe burgoset për veprimtari politike dhe dënohet me 6 vite burg[78]. Tri vite ka qëndruar në burg bashkë me Islam Bravën në Mitrovicë të Sremit.

[77] Informatë e Nuri Bravës (1934) dhënë autorit Shaban Çupi më 3.10.2013, Puset e Nikës

[78] Po aty

Procesi edukativo-arsimor pranë objektit xhami-shkollë u mbajt nga viti 1947 e deri në vitin 1957 dhe në këtë vit, pasiqë Hajdar Daci shpërngulet në Shkup, shtëpia e tij shndërrohet në shkollë dhe nëpër kohë kemi arritur të ruajmë objektin shkollor në këtë formë që shihet në fotografi.

Mësuesit që punuan në shtëpinë e Hajdar Dacit janë:
Shaban Dura nga Kaçaniku, Hajzer Bajrami nga Kaçanolli i Shalës së Bajgorës, Shaban Begolli po nga i njëjti fshat i Shalës së Bajgorës, Hisni Loku nga Kotlina, Ilaz Spahiu nga Drenica, Hazir Bushi nga Puset e Nikës. Mësimi pranë këtij objekti është mbajtur deri në vitin 1970, ku edhe dnërtohet shkolla e re mbi Bushët e Poshtëm.

Lloje të oxhaqeve në Puset e Nikës

Emërvënia në trevën e Hanit të Elezit

Krahas hulumtimeve tjera si ato toponimike, mikrotoponimike, materiale e shpirtërore, në një trevë të caktuar etnografike, një rol të veçantë luan edhe emërvënia e fëmijëve, përkatësisht pagëzimi i tyre.

Pra, emrat që bartim ne, natyrisht se na i kanë vënë të tjerët dhe emrat që bartim ,,nuk është uni ynë, botëkuptimi ynë, por në fakt , ata janë botëkuptimi i brezit që na pagëzoi me këto emra, pra botëkuptimi i prindërve tanë''[79].

Meqë emrat qenkan botëkuptim i brezit që na ka pagëzuar dhe nuk janë thjeshtë një shenjë emërtimi për t`na dalluar nga të tjerët, në vitin 2015, bëmë një hulumtim të emërvënies së fëmijëve në trevën e Hanit të Elezit dhe gjetëm këto rezultate.

Hulumtimin e mbështeta në dokumentet zyrtare të komunës dhe konstatuam se në vitin 2015 në komunën e Hanit të Elezit kanë lindur 142 fëmijë.

[79] Hidajete Azizi ITKSHKSH – Scupi nr. 9 fq 94

Nga gjithësejt 142 fëmijë, 62 janë të gjinisë femërore, ndërsa 80 janë meshkuj dhe nga ky aspekt konstatojmë se nataliteti i meshkujve për vitin 2015 është për 18 më i madh se sa i femrave. Nëse i shprehim në përqindje , kemi këtë rezultat:
Femra janë 43.66 % , ndërsa meshkuj janë 56.33 %, ndërsa gjatë vitit 2015 kanë vdekur 38 persona.
Nga 142 emra fëmijësh, konstatuam se:
Emra me bazë shqipe janë 47 ose 33.09%
Emra mysliman(turko-arab) janë 82 sosh ose 57.74 %
Emra internacional janë 13 ose 9.15%
Konstatojmë se nga emërtimet e fëmijëve për vitin 2015, më së shumti emrat kanë prejardhje turko-arabe, përkatësisht myslimane me 57.74 %.
Nga përqindja e këtyre emrave më i theksuari është emri Anik, Ajan, Ajana, ndërsa numri i emrave të vjetër si Emine, Jahi, Ramadan kanë pësuar rënie dhe nga 82 emra mysliman vetëm 17.07 % e tyre janë emra të trashëguar.
Një karakteristikë tjetër e emrave mysliman është se më së shumti janë emra me prejardhje turke si Aminah, Ajan, Elma, Arza, Eliza, Ajla, Kanita, Tara, Amra, ndërsa me prejardhje nga gjuha arabe kemi : Meke, Furkan, Muala, Ensar, Resul dhe mbizotërojnë emrat myslimanë me prejardhje turke.
Nga 142 fëmijë të lindur, emrat me bazë shqipe i kanë 47 fëmijë ose vetëm 33.09% dhe në emërtimet e këtij viti, si emra karakteristik kemi hasur: Diellza, Rona, Erza, Rina, Albion, Artan, Endrit, por shquhen edhe emrat planetar si Yll, Mars, Ozon, madje emrin Yll e kemi në tre raste.
Një karakteristikë tjetër e pagëzimit të fëmijëve në komunën e Hanit të Elezit shquhen edhe emrat të cilët nuk kanë as prejardhje shqipe e as myslimane dhe këtë kategori emrash i kemi quajtur internacional si: Ledion, Lion, Riola, Liana, Feroza, Fabiola, Neron, Rubina, Liana dhe shprehur në përqindje kemi 9.15%.
Nëse emrat janë një pasqyrë e mirë e shpirtit dhe e karakterit të popullit, atëherë konstatojmë se emrat fetarë janë dominues dhe

përfshijnë një përqindje jo të vogël 57.74 % dhe kjo përqindje dallon nëpër kohë dhe ngjarje historike.
Për të krahasuar hulumtimin e vitit 2015, bërë në nivel të komunës, me një vendbanim të caktuar, ne bëmë një hulumtim në shkollën fillore „Kështjella e Diturisë'' në fshatin Paldenicë, me emrat e nxënësve nga klasa e parë deri në pestën, përkatësisht nga viti shkollor 2010 deri në vitin 2015 dhe gjetëm këto rezultate.
Gjetëm se të regjistruar pranë kësaj shkolle ishin 118 nxënës.
Emra me bazë shqipe kemi 68 nxënës ose 57.62 %
Emra me bazë fetare kemi 46 nxënës ose 38.98 %
Emra internacional kemi 4 nxënës ose 3.38%
Me këtë hulumtim krahasues, konstatojmë se emërtimin e fëmijëve e kushtëzojnë shumë faktorë, në rend të parë botëkuptimi i prindërve, zhvillimi arsimor, kulturor, social, psikologjik, fetar e krahinor.
Për të zbërthyer më gjerësisht emërvënien apo pagëzimin e fëmijëve, në zbritëm për dy dekada më poshtë, përkatësisht në vitin 1991 të shekullit XX dhe bazuar në të dhënat nga libri i amzës në komunën e Hanit të Elezit, konstatuam se:
Të lindur gjatë këtij viti janë 158 fëmijë.
Të gjinisë mashkullore janë 76 fëmijë ose 48.10%
Të gjinisë femërore janë 82 fëmijë ose 51.89 %.
Që donë të thotë se 3.79 % më shumë kanë lindur femra.
Kur analizojmë prejardhjen e emrit, konstatuam se:
Nga gjithësejt 158 fëmijë të lindur në vitin 1991, 92 fëmijë kanë emra fetar me bazë turko-arabe ose shprehur në përqindje 58.22%.
Nga 158 fëmijë të lindur në vitin 1991, 65 fëmijë kanë emra me bazë shqipe ose shprehur në përqindje është 41.13 %.
Emër internacional në vitin 1991 është evidentuar vetëm një rast ose 0.63%.
Viti 1990, 1991, shënon edhe shembjen e komunizmit jugosllav e krahas kësaj, në Kosovë kanë ndodhur ngjarje nga më të ndryshmet si, 2 korriku – Dita e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, pastaj 7 shtatori-Dita e Kushtetutës së Kaçanikut dhe si produkt i ngjarjeve të tilla shoqërore, në listën e gjatë të emrave

shquhen këto emra burimor shqip e që nuk janë karakteristikë për dekadat e më hershme, si :
Driton, Lind, Albana, Fitore, Lirim, Dardan, Arbnor, Liridona, Arbnora, Abetare, Ilir, Flamur, Albulena e të ngjashëm.
Krahas kësaj, në këtë vit shquhet edhe emri Durim dhe Pajtim, emra të cilët u prodhuan si rezultat i situatës politike e shoqërore që mbretëronte atë kohë në Kosovë, rrjedhimisht edhe në trevën e Hanit të Elezit.
Gjithnjë duke bërë krahasime nëpër dekada, në vitin 1982 në trevën e Hanit të Elezit kanë lindur 191 fëmijë. Meshkuj janë 109 fëmijë ose 57.06%, kurse femra janë 82 ose 42.93 %.
Fëmijët e lindur që emrin e kanë me bazë fetare (turko –arabe) janë 150 ose 78.50 %, ndërsa emra me bazë shqipe kemi 41 fëmijë ose 21.46 %.
Meqenëse një vit më parë kishin ndodhur ngjarjet e njohura të vitit 1981, gjatë vitit 1982 kemi këto emra karakteristikë si: Kosovare, Fatmire, Shqipe, Ismail, Teutë, Afërditë, Burim, Driton.
Kur hulumtuam regjistrimin e fëmijëve të lindur në vitin 1955, ekskluzivisht gjetëm emra me përmbajtje fetare dhe me këtë konstatojmë se emërvënia ka një rëndësi të madhe dhe është rezultat i bindjeve, koncepteve, zhvillimit arsimor, kulturor e shoqëror të familjes dhe individit.

Rituali i vdekjes në trevën e Hanit të Elezit

Si në çdo trevë tjetër etnogjeografike, edhe treva e Hanit të Elezit, krahas lindjes e gëzimeve, fejesave e martesave, ka edhe hidhërime, ka edhe pikëllime, ka edhe vdekje. Vdekja, si fundi i jetës, përshkruhej me dhembje familjare e farefisnore. Në të kaluarën, vdekja konsiderohej një mort i cili përshkruhej edhe me gjëmë, me vaje e grrithje fytyrash e rënie gjoksash, gjithsesi një ritual i vjetër pagan për të cilat shkruan edhe Herodoti, por që është përdorur edhe në trevën e Hanit të Elezit.

Nga kujtesa popullore mësojmë se vajtimi i të vdekurit është bërë pothuajse në të gjitha shtëpitë. Ka ekzistuar grupi i veçantë i vajtoreve që të vdekurit ia bënin gjamën dhe ky relikt mortor në trevën e Hanit të Elezit është përdorur deri kah viti 1957[80] i shekullit XX.

Grupi i vajtueseve, i cili duhej t`i kishte disa anëtarë, e rrethonin të vdekurin në formë gjysëmrrethi dhe fillonin t`ia qanin të gjitha të mirat që kishte pasur gjatë jetës së tij, të bëmat e tij, burrërinë, trimërinë, namin, por vajtonin edhe vendin e zbrazët që do të mbetet tani e tutje, duke u munduar t`ia preknin gjitha tiparet e tij apo të saj.

Qyqja e mjera un n`ket shpi
A`t`kjaj vedin a t`kjaj ty?
Oj e mjera nanë për ty! Hej.....Hej[81]

Vajtimi i të vdekurit në Mirditë[82]

[80] Informatë nga Elham Kalisi (Seçishtë), Sefer Çupi (Paldenicë) dhe Mahi Lusnjani (Guranë) dhënë autorit në vitin 2016
[81]Visaret e kombit-vëllimi III fq. 185
[82] Burimi: Interneti

Kishte raste kur kënga e vajës nuk përputhej me cilësitë e të vdekurit, por kështu ishte adeti, duhej që të vdekurit t`i bëhej edhe ky nderë. Por kur ndodhte të vdiste ndonjë djalë i ri apo vajzë e re atëherë dhembjet ishin të mëdhaja, por edhe vajtimi bëhej thekshëm. Në vende të tjera, sidomos në krahinën e Mirditës, i vdekuri vishej sikur të ishte i gjallë me plis, tirq e xhurdi e ulnin në sandali, ia afronin pushkën , duhan e cigare dhe e bënin si të ishte i gjallë dhe pastaj i bënin gjëmën.
Kur i sëmuri lëngonte relativisht gjatë në shtrat, ishte adet që të sëmurin ta vizitonin miqtë e farefisi, sepse ,,i sëmuri t`i lenë mollat në xhep''.
Në çastin kur të sëmuarit i ,,shuhej kandili'' , së pari me një shami i lidhej koka me nofull që të mos i mbetej goja hapur, i mbylleshin sytë, lidhej gishti i madhë i këmbës së djathtë me të majtën që të mos i mbesin të vdekurit këmbët hapur, duart ia bashkonin në mes të trupit dhe mbi bark i vendosej një peshë më e rëndë që të mos i fryhej barku. E tëra kjo bëhej sa trupi është i nxehtë dhe qëllimi ishte që kufoma e të vdekurit të dukej sa më e mirë.
Pas këtij rituali, njoftohej farefisi, ndërsa nga minareja e xhamisë, njoftohej katundi dhe tregohej koha e varrimit. Ishte traditë që i vdekuri apo e vdekura të varroseshin në ditën që vdiste. Kjo mund të shtyhej për ditën e nesërme, vetëm atëherë kur personi vdiste pasdite vonë dhe nuk kishte kohë t`i bëhej varrimi në të njëjtën ditë. Në këto raste ishte adet që i vdekuri të ruhet gjatë natës, mos të lihej vetëm. Grupet e rojes ndërroheshin herë pas here deri në mëngjesin e ditës së nesërme. Gjatë ruajtjes së kufomës, të pranishmit luteshin për shpirtin e të vdekurit dhe nuk hanin e as pinin.
Pasi njoftoheshin miqtë e farefisi, atëherë vinte hoxha i fshatit dhe fillonte përgatitja për varrim. Në rend të parë caktohej njeriu që duhej të shkonte për ta blerë qefinin, ndërsa të tjerët fillonin punën për përgatitjen e varrit. Gjatësia e trupit të të vdekurit matej me një penj ose shkop dhe kjo bëhej për të rregulluar gjatësinë e

varrit. Varri i burrit bëhej deri në bel, ndërsa varri i gruas gropohej më thellë. Zakonisht, me hapjen e varrit nuk merrej familja, por farefisi dhe vlen të theksohet se ishte një mobilizim i tërë fshatit dhe kështu është edhe sot. Një pjesë hapnin varrin, një pjesë tjetër gdhendnin ponicat(dërrasat) të cilat zakonisht merreshin nga zabeli i vakëfit. Ponicat kryesisht ishin nga drunjtë e bungut, pasi që vakëfi kishte lisa të vjetër e të gjatë. Në vakëf askush nuk merr ndonjë dru për nevoja shtëpiake sepse është ,,haram'' dhe mallkohej njeriu që bënte një veprim të tillë.

Pasi hapej varri dhe përgatiteshin ponicat, pjesa tjetër në shtëpi përgatiste larjen e kufomës, hoxha qepte qefinin, ndërsa kur i vdekuri ishte femër, përgatitjen e kufomës e bënte gruaja e hoxhës.

Larja e kufomës bëhet me ujë të nxehtë në një hapësirë të oborrit. Vendi rrethohej me batanije ose cerga dhe në larjen e kufomës merrnin pjesë anëtarët e familjes. Pasi lahej e vishej me qefin kufoma, vendosej në tabut, ndërsa fytyra për disa minuta i lihej e hapur nga qefini dhe ftoheshin njerëzit që ,,të pjeken''me të vdekurin. Ishte zakon që hallalli të merrej dhe jepej vetëm me dorën e djathtë duke lëvizur dorën mbi fytyrën e të vdekurit.

Kur përfundonte edhe ky rit, atëherë, të vdekurin e nisnin për tek varret. Tabutin e bartin katër vetë në krah dhe ndërroheshin me të tjerë herë pas here. Mbi tabut vendosej një peshqir, kur i vdekuri ishte mashkull, ndërsa një shami kur ishte femër dhe nëse një udhëtar rastësisht takon xhematin, nga peshqiri ose nga shamia kuptonte gjininë e të vdekurit. Gjatë bartjes së të vdekurit, zakonisht nuk flitej, por xhemati lutej për shpirtin e të vdekurit dhe pjesëmarrja e tyre në varrim, nga predikimet fetare, mësohej se sevapet janë të shumta, sa ,,tri Kodra të Uhudit''.

Kur mbërrinte kufoma te varri, vendosej mbi gurin e rrafshët i cili quhet tebeshir. Xhemati rreshtoheshin në rende ,,safe'' dhe fillonte falja e namazit të xhenazes, pa të cilin nuk bën i vdekuri të varroset. Pas kësaj, i vdekuri vendoset në varrin apo shtëpinë e tij të përjetshme. Koka kthehet nga perëndimi, ndërsa këmbët në drejtim të lindjes. Kufoma kthehet pak, krejtësisht pak në krah të

djathtë, ndërsa nën kokë i vendoset një tis i vogël dheu. Pas kësaj, varri mbulohet me ponica të cilat duhen të jenë të gdhendura mirë dhe të bien në ,,gojë''njëra me tjetrën dhe dheu të mos i bie në fytyrë të vdekurit. Kjo bëhet nga respekti që kanë të gjallët mbi të vdekurin. Ponicat vendosen afërisht në këndin 70 shkallë dhe më pastaj mbulohet varri me dhe. Mbi varrë, te koka dhe te këmbët vendosen nga një dru i gdhendur dhe pas lutjes përfundimtare të hoxhës, përfundon varrimi i të vdekurit.

Pas kësaj, farefisi rreshtohet në rresht dhe pjesëmarrësit shprehin ngushëllime. Të nesërmen fillonte e pamja e cila në të kaluarën ishte shumë ditë deri më tre javë. Varësisht nga largësia, ata që vinin në të pame u shtrohej edhe bukë, kafe, çaj e duhan dhe zakonisht vinin në mënyrë të organizuar ta zëmë tubohej fshati nga një anëtarë për familje dhe e kryenin të pamën.

Tani e pamja është më ndryshe dhe më e lehtë krahasuar me kohët më të vjetra. Rituali fetar është pothuajse i njëjtë se ka të bëj me fenë, ndërsa pjesa tjetër është ndryshuar. Që nga momenti që vdes njeriu, pos njoftimit të farefisit, një anëtar i familjes shkon në Bashkësinë Islame dhe pasi e njofton kryeimamin, merr qefinin dhe ponicat të cilat nga viti 2010 shpenzimet e varrimit i heq gratis komuna.

Pritja nuk është si më parë, (tre javë ditë), por që nga viti 2010 është caktuar pesë ditë. Në pamje nuk ,,shkepen'' as duhan, kafe e çaj, por vetëm ngushëllohet familja dhe kjo zgjatë për pak minuta.

Në trevën e Hanit të Elezit, ende ruhet adeti, që ata që presin e përcjellin tërë ditën njerëzit për ngushëllime, të hanë drekë në shtëpinë e të vdekurit. Në pritje marrin pjesë familja, farefisi dhe njerëz të caktuar nga fshati.

Treva e Hanit të Elezit, me nëntë mijë banorë e mbi 13 vendbanime, në aspekt religjioz është e përkatësisë islame. Në qytezën e Hanit të Elezit, kemi dy xhami; Xhamia e Vjetër e ndërtuar në vitin 1964 dhe ajo e Çarshisë e ndërtuar në vitin 2003. Xhamia në Lagje të Re e ndërtuar në vitin 1994, në Seçishtë 1829, në Kryenik 1690, në Guranë 1850, në Rezhancë 1952, në Puset e

Nikës 1936 dhe në Paldenicë e ndërtuar në vitin 1926[83]. Fshati Laç, Dimcë, Vërtomicë, Neçavc e Dërmjak asnjëherë nuk kanë pasur objekt xhamie, por janë shërbyer në xhamitë e vendbanimeve për rreth.

Në hulumtim të varrezave të trevës së Hanit të Elezit që e kam bërë në vitin 2009, varrezat kanë gjurmë të vjetra, mbi varr janë vendosur mbishkrime në gjuhën osmane dhe në fund të mbishkrimit shkruan viti i vdekjes. Guri më i vjetër i shkruar është ai i vitit 1650 në fshatin Kryenik, pastaj në fshatin Paldenicë i vitit 1707 e kështu me radhë. Varësisht prej imamit, gjurmët e vjetra të dervishizmit gjenden në fshatin Kryenik, Dërmjak e Vërtomicë, ndërsa në varrezat tjera nuk ka gjurmë të tilla. Mbishkrimet janë të shkruara në gjuhën osmane, ndërsa viti i vdekjes është i shkruar në vitin kalendarik hënor ose në hixhri dhe zakonisht në mbishkrim është flamuri turk me yll e hënë. Kjo formë e mbishkrimit tanimë nuk përdoret. Tani mbishkrimet natyrisht që shkruhen në gjuhën shqipe, ndërsa në ballë të gurit është e gdhendur shqiponja.

Pas Luftës së Dytë Botërore, objektet e xhamive, kanë qenë edhe shkollat e para shqipe, pasiqë shkolla shqipe ishte e ndaluar në kohën e krajlit dhe nuk kishte objekte shkollore, madje edhe mësuesit e parë, kishte raste që ishin me medresenë e kryer, në Tiranë e Shkodër.

Në kohët më të hershme, hoxhallarët ishin nga trevat tjera duke filluar nga Shkupi, Dibra, Tetova, Ferizaj, Kaçaniku, Presheva e vendbanime të tjera shqiptare, ndërsa sot, imamët që punojnë aktualisht në trevën e Hanit të Elezit, janë të gjithë nga vendbanimet e kësaj treve dhe kanë të kryer fakultete teologjike.

[83]Më gjerësisht: Shaban Çup " Historiku i xhamive dhe shkrimet mbivarrore në trevën e Hanit të Elezit'' 2009